

PROGRAMI I QEVERISE

2005-2009

Paraqitur ne Kuvendin e Shqiperise

Tirane me, 08.09.2005

PERMBAJTJA

OBJEKTIVAT E SHOQERISE SHQIPTARE DHE QEVERISJA

SYNIMET THEMELORE DHE REFORMAT ME TE RENDESISHME TE QEVERISJES PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM

KONSOLIDIMI I SISTEMIT DEMOKRATIK DHE GARANTIMI I TE DREJTAVE THEMELORE TE NJERIUT

SISTEMI ZGJEDHOR

REFORMAT INSTITUCIONALE

Kuvendi

Drejtesia

Decentralizimi dhe autonomia vendore

Reformimi i ekzekutivit qendror dhe administrata publike

TE DREJTAT THEMELORE

Te drejtat pronesore. Kthimi i pronave

Te drejtat e minoriteteve etnike. Romet dhe Egjiptianet

E drejta e informimit dhe liria e medias

Garantimi i procesit te drejte ligjor

Liria e besimit

ZBATIMI I PLOTE I LIGJIT- SHTETI LIGJOR

LUFTA KUNDER KORRUPSIONIT- QEVERISJE ME DUAR TE PASTRA

Parandalimi i korrupsionit. Transparenca. Perfshirja

Ndeshkimi i korrupsionit

RENDI PUBLIK. LUFTA KUNDER KRIMIT, TRAFIQEVE E TERRORIZMIT

Lufta kunder krimit te organizuar e trafiqeve

Angazhimi ne luften kunder terrorizmit

Ulja e parandalimi i krimit ordiner

Siguria rrugore

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE E NJEREZORE PER ZBATIMIN E LIGJIT

SISTEMI I INFORMACIONIT E DOKUMENTACIONIT

SHTETI DHE ZYRTARET E TIJ - TE PARET QE ZBATOJNE LIGJIN

QEVERIA NE BASHKEPUNIM ME INSTITUCIONET E PAVARURA PER ZBATIMIN E LIGJIT

BASHKEPUNIMI ME PARTNERET NDERKOMBETARE
EDUKIMI LIGJOR

ZHVILLIMI I SHPEJTE DHE I QENDRUESHEM EKONOMIK E NJEREZOR
HAPJA E TREGUT. KONKURRENCA E LIRE DHE E NDERSHME

Garantimi i te drejtave pronesore e tregtare

Konkurrenca e lire dhe anti-monopoli

Te drejtat e konsumatorit

Reduktimi i barrierave administrative

Informacioni ne sherbim te tregut te lire

Partneriteti publik- privat bazuar ne rregullat e tregut te lire e te konkurrences se ndershme

ZHVILLIMI I TREGUT BANKAR E FINANCIAR. RITJA E KREDITIMIT

Mbikqyrja dhe rregullimi i sektorit financiar

Tregu bankar dhe rritja e kreditimit

Zgjerimi i mikrokredise

Tregu i kapitaleve dhe Bursa e Tiranes

Tregu i sigurimeve

REDUKTIMI I PESHES SE EKONOMISE INFORMALE

SHQIPERIA: VENDI ME ATRAKTIV PER INVESTIMET E HUAJA

GARANTIMI I STABILITETIT MAKROEKONOMIK

Ulja e deficit buxhetor dhe e borxhit publik

Norma e pershtatshme vjetore e inflacionit

Treguesit e tjere makroekonomike

POLITIKAT DHE ADMINISTRIMI FISKAL

Sherbimi i te hyrave publike. Administrimi fiskal. Disiplina, transparenca, thjeshtesia dhe ndershmeria fiskale.

Me pak taksa - shkalle tatimore me te uleta

PRIORITETET E ZHVILLIMIT DHE SHPENZIMET BUXHETORE

BUXHETIMI BAZUAR NE PRIORITETE. TRANSPARENCA DHE PJESEMARRJA. ADMINISTRIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE.

ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURES

Transporti, rruget, portet dhe aeroportet

Sigurimi i ujit te pijshem per cdo familje

Energji e mjaftueshme, e lire dhe e garantuar

Telekomunikacioni i lire, cilesor dhe i shumellojshem per te gjithë shqiptaret

ZHVILLIMI NJEREZOR

Arsim cilesor dhe masiv

Sherbim shendetesor i garantuar, cilesor dhe i ndershem

Kultura dhe sporti ne sherbim te zhvillimit ekonomik e njerezor

PRIORITETET E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE POLITIKAT MBESHTETESE

Turizimi dhe rritja e e tij e shpejte, cilesore dhe shumeformeshe

Kalimi nga aktiviteti bujqesor ne biznesin agrar. Zhvillimi i agroindustrise.

Rritja e konkurrueshmerise dhe kapja e tregjeve per eksport.

ZHVILLIM I INTEGRUAR E HARMONIK URBAN, RURAL DHE MBROJTA E MJEDISIT

Zhvillimi i integruar rural perfshire zonat malore te vendit

Zhvillimi harmonik e i qendrueshem urban. Legalizimi i banesave.

Mbrojtja e mjedisit dhe perdorimi i qendrueshem i burimeve natyrore

NATYRA SOCIALE E SHTETIT.

PUNESIMI I PLOTE. REDUKTIMI I PAPUNESISE

PAGAT DHE PENSIONET

REDUKTIMI I VARFERISE DHE KUJDESI SOCIAL

Reduktimi i varferise

Kujdesi social per grupet dhe individet ne nevoje

Zgjidhja e problemit te familjeve te pastreha

Kujdesi dhe integrimi i ish te perndjekurve politike

Respekti dhe kujdesi pa diskriminim ndaj veteraneve

KUJDESI PER EMIGRACIONIN. INTEGRIMI I EMIGRANTEVE TE RINJ E TE VJETER NE

ZHVILLIMIN E VENDIT

Perfshirja aktive e emigranteve ne zhvillimin e vendit

Perkushtimi per mbrojtjen dhe garantimin e te drejtave te emigranteve

BARAZIA GJINORE

INTEGRIMI EUROPIAN DHE EUROATLANTIK.

ZBATIMI DHE KOORDINIMI I REFORMAVE EUROPIANIZUESE E INTEGRUESE

POLITIKA E JASHTEME NE FUNKSION TE INTEGRIMIT EUROPIAN E EUROATLANTIK, TE PAQES E STABILITETIT RAJONAL

SIGURIA KOMBETARE. ANETARESIMI NE NATO. KONTRIBUTI I SHQIPERISE PER PAQEN DHE SIGURINE GLOBALE

100 DITET E PARA TE QEVERISJES DHE VITI 2006

100 DITET E PARA TE QEVERISJES

VITI 2006 I QEVERISJES

OBJEKTIVAT E SHOQERISE SHQIPTARE DHE QEVERISJA

1. Zhvillimi i gjithanshem, i shpejte dhe i qendrueshem si dhe integrimi europian dhe euroatlantik i vendit jane synimet madhore te shqiptareve arritja e te cilave kerkon nje mobilizim kreativ dhe produktiv te energjive individuale dhe shoqerore, private dhe publike.

2. Shoqeria shqiptare, cdo individ, familje, komunitet, kane demonstruar gjate ketyre viteve te tranzicionit:

- vullnet te palekundur per arritjen e ketyre synimeve dhe nje ndarje te qarte e te pakthyeshme me te kaluaren;
- aftesi per te perballuar sfidat e per te ndermarre nisma private apo publike;
- pranueshmeri te kostove te reformave;
- qytetari per te bashkejetuar ne nje sistem ne hapje dhe integrim;
- tolerance dhe bashkejetese pavaresisht nga perkatesite etnike e fetare aq te domosdoshme per paqen dhe prosperimin e vendit, rajonit te Ballkanit e me gjere, dhe
- gatishmeri per te kontribuar ne ceshtjet e medha te paqes dhe drejtesise ne nivel global dhe luftes kunder terrorizmit;

3. Kjo sjellje konstruktive dhe perparimtare e shoqerise shqiptare rrit pergjegjesine e elites politike per te ofruar nje qeverisje te sherbimit dhe sherbesave per qytetaret, efektive dhe eficente po aq sa te perkushtuar dhe te pergjegjeshme per te mundesuar arritjen e synimeve mbare kombetare te zhvillimit dhe integritimit.

4. Mazhoranca e re e dale nga zgjedhjet e 3 Korrikut 2005 vlereson si te domosdoshem realizimin e ndryshimeve thelbesore ne qeverisje per t'i ofruar shqiptareve nje qeverisje qe eshte ne sinkron me endrrat, vullnetin, energjine dhe nismat krijuese te tyre, nje qeverisje qe behet faktor i nxitjes se proceseve zhvilluese dhe i pershpjtitimit maksimal te integritimit europian dhe euroatlantik te vendit.

5. Mazhoranca e re u ofron shqiptareve mundesine per te ndryshuar rrjedhen e se ardhmes drejt zhvillimit dhe integritimit dhe njekohesisht rritjen e ritmeve te arritjes se ketyre synimeve nepermjet:

- Perkushtimit dhe pergjegjshmerise se larte ne ustrimin e pushtetit, cmontimit te sistemit te korrupsionit dhe monopoleve, luftes kunder fenomenit te korrupsionit, krimin te organizuar dhe trafikeve kriminale.
- Realizimit me vizion te qarte e me ritem te larte te reformave te medha te qeverisjes demokratike, te shtetit ligjor dhe te zhvillimit ekonomik e njerezor;

6. Programi i ndryshimit i mazhorances se re dhe perkushtimi e ndershmeria, transparenca qeverisese e saj jane dy faktore te pazgjidhshem, plotesisht ne sinkron me sjelljen dhe vullnetin individual e shoqeror te shqiptareve, qe do te mundesoje rritjen ekonomike 6-8% dhe shnderrimin e saj nga rritje ekonomike e bazuar kryesisht ne pasurimin e oligarkive ne rritje ekonomike, per te gjithë e vecanerisht per te varferit nepermjet rritjes edhe me te shpejte por edhe shperndarjes se drejte te te ardhurave per fryme, zbutjen e pabarazise, reduktimin e shpejte te varferise, rritjen e shkalles se arsimimit e permiresimin e shendetit publik, zhdukjen e erresires e te etjes, mjedisin e paster, zhvillimin e balancuar rajonal.

7. Per rrjedhoje, nje zhvillim i tille i vendit dhe serioziteti qeverises do ta bejne Shqiperine nje

partnere te denje dhe nje vend te mirepritur ne bashkesine nderkombetare duke siguruar brenda gysmes se pare te mandatit mbylljen me sukses te fazes se pare te Marreveshjes se Stabilizim-Asociimit dhe nisjen e procesit te aplikimit per anetaresim ne Bashkimin European si dhe pershpjtimin e antaresimit ne NATO duke siguruar ftesen per kete antaresim gjate vitit te ardhshem.

SYNIMET THEMELORE DHE REFORMAT ME TE RENDESISHME TE QEVERISJES PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM

8. Synimet themelore te reformave te qeverisjes per kater vitet e ardhshme jane:

- zhvillimi e konsolidimi i shtetit demokratik ne temel te te cilit qendrojne lirite dhe te drejtat themelore te individit;
- rikthimi i forces se shtetit ligjor ku ligjet zbatohen plotesisht dhe ne menyre te barabarte per te gjitha, cmontimi i sistemit te korrupsionit;
- zhvillimi i shpejte, i balancuar e i qendrueshem ekonomik e njerezor;
- integrimi i Shqiperise ne BE dhe NATO.

9. Progresi i njekoheshem ne te kater objektivat madhore do te shenoje mbylljen e tranzicionit, sherimin e problemeve te medha te nenzhvillimit vecanerisht ato te varferise, te shendetit publik, te arsimit dhe te aksesit ne sherbimet baze publike, degradimit te mjedisit dhe kalimin e vendit ne fazen e nje ecjeje te shpejte drejt integrimin europian dhe euroatlantik.

10. Te gjitha reformat dhe programet qeveritare do te hartohen dhe zbatohen me synimin e pershtatjes me modelet dhe arrijtes se standarteve europiane te demokracise, shtetit ligjor, ekonomise se tregut e te te drejtave te individit dhe minoriteteve qe mundesojne anetaresimin e Shqiperise ne Bashkimin European e ne NATO.

KONSOLIDIMI I SISTEMIT DEMOKRATIK DHE GARANTIMI I TE DREJTAVE THEMELORE TE NJERIUT

11. Progresi i sistemit demokratik ne Shqiperi ka ardhur si rezultat i veprimit te natyrshem te forcave progresiste te shoqerise si dhe i mbeshtetjes e presionit konstruktiv te partnereve nderkombetare mbi qeverisjet e viteve te fundit. Nderkaq, vendosja e sistemit te korrupsionit, dhunimi i zgjedhjeve te lira dhe moszbatimi, zbatimi i dobet, i shtremberuar ose vonesat ne kryerjen e reformave kane shkaktuar humbjen ne shkalle te gjere dhe ne nivele teper te larta te besimit te shqiptareve ne institucionet shteterore te cilat jane inefficente, te dobeta, jo-transparente dhe thellesisht te korruptuara.

12. Mazhoranca e re dhe qeveria e saj u ofron shqiptareve nje program te plote reformash institucionale dhe ligjore te ndryshimit te gjitha te orientuara drejt modeleve e standarteve europiane dhe nje motivim politik e vullnet te hekurt per kryerjen e tyre, si edhe arrijten e rezultateve te prekeshme e te vleresueshme per konsolidimin e sistemit demokratik dhe respektimin e lirive dhe te

drejtave themelore te njeriut. Reformat kryesore ne kete fushe do te jene:

SISTEMI ZGJEDHOR

i) Zgjedhjet e lira e te ndershme do te jene burimi i vertete i legjitimitetit te institucioneve demokratike. Kthimi i besimit te publikut tek zgjedhjet eshte nje prioritet absolut i mazhorances se re e qeverise se saj. Manipulimi me voten e qytetareve do te marre fund njehere e pergjithmone. Per kete qellim do te perfundohet reforma zgjedhore ne bashkepunim dhe mirekuptim me opoziten, si dhe me mbeshtetjen e konsultimin me partneret nderkombetare e me te gjitha faktoret e tjere shoqerore.

§ Do t'i jepet fund pa medyshje perjashtimit te zgjedhesve nga listat e votimit dhe "Dushku" do arkivohet ne histori.

§ Krahas lirise dhe ndershmerise se zgjedhjeve, reforma zgjedhore do te mundesoje te drejten e te gjitha shqiptareve, kudo qe jane, per te marre pjese ne zgjedhje.

§ Transparenca e financimeve te partive dhe kandidateve ne zgjedhje do te jete gjithashtu nje tjetër objektiv madhor i reformes zgjedhore.

§ Maxhoranca dhe qeveria e saj deklarojne se zgjedhjet ne Shqiperi, duke filluar nga ato vendore te vitit 2006 do te jene ne perputhje te plote me standartet europiane e nderkombetare qe percaktojne karakterin e lire e te ndershem te tyre.

REFORMAT INSTITUCIONALE

ii) Respektimi dhe garantimi i pavaresise se pushteteve do te siguroje funksionim e institucioneve bazuar ne Kushtetute dhe ne ligj ndersa nisja dhe/ose vazhdimi i zbatimit te reformave institucionale do te rrise efektivitetin, eficencen dhe pergjegjshmerine e veprimtarise se institucioneve themelore te shtetit demokratik.

Kuvendi

§ Mazhoranca e re, ne projektin e saj te ndryshimit do t'i jape nje dimension te ri rolit te Kuvendit si tempull i demokracise parlamentare dhe shprehes i vullnetit te zgjedhesve. Ne vecanti roli kontrollues i deputetit dhe i Kuvendit ne teresi mbi te gjitha veprimtarine e ekzekutivit dhe te institucioneve te tjera mbi te cilat ai e ka kete kompetence do te marre nje rendesi te vecante. Ne kete drejtim mazhoranca e re angazhohet per ofrimin e hapësirave shume me te gjera te rolit dhe veprimin te opozites,

te drejtave, kerkesave, propozimeve te saj. Kuvendi do te jete nje organizem teresisht i hapur per te degjuar dhe thithur mendimin e publikut e te grupeve te ndryshme te interesit ne iniciativat e tij ligjvenese, por njekohesisht i siguruar nga risqet e kapjes te cilat kane patur nje rritje dramatike gjate qeverisjes se meparshme dhe bien ndesh e demtojne rende interesin publik.

Drejtesia

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj, ne projektin e tyre te ndryshimit, do te zbatojne ne gjeresi dhe thellesi reformat e sistemit te drejtesise, te sugjeruara e te mbeshtetura nga partneret nderkombetare dhe ne bashkepunim e sipas roleve perkatese kushtetuese me Presidentin, Keshillin e Larte te Drejtesise dhe institucionet e tjera qe perfshihen ne ceshtjet e reformave dhe performances se sistemit te drejtesise. Komuniteti i gjyqtareve dhe juristeve si dhe shoqeria civile do te jene gjeresisht te perfshire ne kete proces. Reformat ne drejtesi do te synojne te rikthejne besimin e shqiptareve ne sistemin gjyqesor dhe ne ndershmerine e paanesine e vendimit gjyqesor. Reforma do te perqendrohet ne drejtimet e meposhtme prioritare:

- garantimi i pavaresise reale te sistemit te drejtesise nepermjet fuqizimit te institucioneve te vetekontrollit dhe administrimit te gjyqesorit;
- forcimi i pergjegjshmerise dhe ndershmerise se vendimit gjyqesor nepermjet rritjes se transparences dhe aksesit, publikimit te plote te vendimeve gjyqesore, permiresimit te sistemit te vleresimit te performances se gjyqtareve dhe te pergjegjshmerise se tyre para ligjit bazuar ne kritere objektive;
- permiresimi i kushteve dhe mjeteve te gjyqesorit, rritja e profesionalizmit te gjyqtareve, si dhe transparences dhe objektivitetit ne emerimet dhe karrieren e gjyqtareve;
- zbatimi me rigorozitet dhe ne cdo rast i vendimeve gjyqesore, ne radhe te pare nga vete institucionet shteterore;
- nxitja e krijimit te formave te tjera alternative te gjykimit si arbitrazhi dhe ndermjetesimi;
- ristrukturimi e forcimi i kapaciteteve ne institucionin e akuzes;
- ristrukturimi dhe forcimi i kapaciteteve te permbarimit dhe hapja e mundesive per permbaruesin privat ne kete fushe;
- reformimi i sistemit te noterise.

Decentralizimi dhe autonomia vendore

§ Qeveria, ne projektin e saj te ndryshimit, do te zbatoje, ne perputhje me karten europiane te autonomise lokale dhe rajonale, me ritme te pershpejtuara dhe te qendrushme, dhe ne konsultim te vazhdueshem me qeverisjen vendore e aktoret e tjere te interesit, reformen e decentralizimit te pushtetit ekzekutiv pasi vlereson se decentralizimi permireson cilesite qeverisese qofte ne drejtim te eficiences dhe efektivitetit po aq edhe ne drejtim te forcimit te pergjegjshmerise, rritjes se transparences si dhe rritjes se perfshirjes se qytetareve dhe komuniteteve e grupeve te ndryshme shoqerore ne qeverisje. Nen qeverisjen e re do te marrin fund diskriminimi i njesive te qeverisjes vendore per shkak te perkatesise politike dhe zvarritja e tejskajshme e zbatimit te strategjise kombetare te decentralizimit e te ligjit organik te qeverisjes vendore. Deri ne fund te periudhes 4 vjecare:

- do te dyfishohet pesha aktuale e shpenzimeve autonome te pushtetit vendor ne buxhetin e shtetit dhe ne PBB te lidhura me funksionet e veta te qeverisjes vendore dhe do te zgjerohet autonomia fiskale e bashkive dhe komunave, te cilat do te vendosin dhe mbledhin vete taksat dhe tarifat vendore. Nderkaq, transfertat nga buxheti i shtetit drejt autoriteteve lokale do te rriten me 3-4 here krahasuar me nivelin e sotem duke u kryer ne menyre transparente e objektive bazuar ne formule analitike.
- Brenda dy vitesh do te perfundoje procesi i transferimit te pronave ne njesite e qeverisjes vendore, me perparesi ujesjellesat, rruget, trojet, shoqerite publike me karakter vendor, objektet social-kulturore.
- do te vihet ne zbatim koncepti i funksioneve te perbashketa ne arsim, shendetesi, mjedis, strehim, sherbime sociale, rend dhe qarkullim rrugor, per te cilat njesite e qeverisjes vendore do te marrin vendime autonome brenda sferes se juridiksionit te tyre dhe do te bashkepunojne, bazuar ne principin e autonomise, subsidiaritetit dhe te partneritetit, me qeverisjen qendrore si dhe mes vete njesive te qeverisjes vendore, per arritjen e objektive kombetare ne keto fusha, sipas prioriteteve vendore per secilen prej ketyre njesive. Alokimi i fondeve per qeverite vendore ne keta sektore publike do te kryhet ne menyre objektive dhe transparente, duke synuar ngushtimin e disbalancave rajonale te derisotme.
- Kufijte e njesive te qeverisjes vendore jane te garantuara me ligj. Cdo ndryshim i mundshem i tyre do te behet ne favor te progresit e mireqeverisjes dhe sipas procesit te hapur e perfshires bazuar ne parimet e Kushtetutes dhe te ligjit organik te qeverisjes vendore

Reformimi i ekzekutivit qendror dhe administrata publike

§ Ne projektin e saj te ndryshimit mazhoranca e re angazhohet per nje qeveri ne sherbim te qytetareve dhe e sherbesave me te mira ndaj qytetareve. Qeveria do te kryeje nje reforme te thelle e te vertete te administrates publike per krijimin e nje rrjeti

institucional efektiv dhe eficient, si dhe te nje administrate te qendrueshme, te perkushtuar ndaj zbatimit te ligjit dhe te ofrimit te sherbimeve me te mira per qytetaret, e afte te prodhoje e te zbatoje politika, me nepunes civile te rekrutuar dhe te vleresuar sipas kualiteteve profesionale, eksperiences, merites dhe perkushtimit ne kryerjen e detyrave.

- Mazhoranca e re angazhohet per nje qeveri te vogel njeherazi ne diete. Shpenzimet qeveritare te natyres jo-produktive e te luksit do te eliminohen ndersa do te pergjysmohen shpenzimet administrative te qeverise ne teresi.
- Ministrite dhe dhe te gjitha institucionet e tjera ekzekutive do te bejne transparente me web dhe me zyrat e informimit te publikut te gjithe veprimtarine e tyre.
- Ministrite dhe institucionet e tjera ne varesi te qeverise do te ristrukturohen ndersa do te mbyllen ose shkurtohen nje rrjet i tere institucionesh e zyrash parazitare.
- Administrata publike do te forcohet e konsolidohet sipas principeve te sherbimit publik, mbi bazen e merites dhe te performances. Mazhoranca e re njeh dhe respekton statusin e nepunesit civil te cdo punonjesi qe e ka fituar ate me merite dhe ai do te jete i garantuar. Qeveria do te permiresoje kualitetet profesionale ne administraten publike nepermjet nje procesi te hapur e konkurrues rekrutimi e karriere, motivimi e shperblimi te performances se mire dhe ndeshikimit te performances se dobet e pandershmerise se nepunesve si dhe trainimin te vazndueshem. Statusi i nepunesit civil do te shtrihet ne pjesen me te madhe te organeve te administrates publike, ndersa pagat ne sektorin publik do te rriten njekohesisht me ngushtimin ne 1 me 5 te diferencave te medha qe ekzistojne sot mes pages maksimale dhe minimale.

TE DREJTAT THEMELORE

iii) Reforma institucionale dhe ligjore si dhe angazhimet qeverisese do te synojne nje garantim dhe realizim ne nivele gjithnje e me te larta te drejtave dhe lirive themelore te individit e ne vecanti te drejtave e lirive politike dhe ekonomike e te garancise per jeten.

Te drejtat pronesore. Kthimi i pronave

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj angazhohen per te plotesuar dhe konsoliduar sistemin e te drejtave te pronesise dhe hapjen e mundesive qe pasurite e vena me djerse, mund, sakrifica e ne menyre te ligjshme te shqiptareve te mund te legalizohen e futen ne qarkullimin ekonomik e civil.

§ Mazhoranca e re angazhohet per nje kthim dhe kompensim te pronave ne kufijte

maksimale te mundur. Per kete qellim do te amendohet ligji aktual duke eliminuar kufizimet diskriminuese te tij. Pronat do te kthehen fizikisht kudo ku eshte e mundur dhe ne cdo rast tjeter ato do te kompensohen ne natyre me troje turistike apo ne vleren e tregut.

Te drejtat e minoriteteve etnike. Romet dhe Egjiptianet

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj angazhohen per te zbatuar dhe arritur standartet me te larta te respektimit dhe realizimit te te drejtave te te gjitha pakicave etnike greke, maqedonase e malazeze, rome, egjiptiane dhe arumune ne perputhje me Konventen Europiane te te drejtave te njeriut dhe Konventen Europiane e te drejtave te minoriteteve. Me prioritet do te konsiderohen sipas nje programi te vecante shkollimi si dhe strehimi e punesimi komunitetet egjiptiane e rome ne menyre qe te kapercen pasojat e diskriminimit kohegjate te tyre.

E drejta e informimit dhe liria e medias

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj e reformave te ndryshimit vleresojne se garantimi dhe realizimi ne standarte sa me te larta i se drejtes themelore per t'u informuar te cdo individi implikon, nga nje ane, nje transparence maksimale qeverisese, nepermjet aksesit te lire dhe te plote ne te dhenat mbi veprimtarine e institucioneveve e deri tek te dhenat personale te zytareve dhe, nga ana tjeter, nje respektim te vertete dhe te sinqerte te lirise se medias dhe te shprehjes se mendimit. Qeveria deklaroi angazhimin dhe perkushtimin e saj maksimal duke e pare lirine e informimit dhe transparencen si mjetin kryesor te qeverisjes se mire dhe luftes kunder korrupsionit. Mazhoranca e re angazhohet se asnje zyrtar politik i saj nuk do te beje padi penale ose civile ndaj gazetareve dhe mediave. Mediat ne asnje rast nuk do te trajtohen ne menyre diskriminuese qofte per interesa politike apo per interesa te tjera.

Garantimi i procesit te drejte ligjor

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj e ndryshimit angazhohen per te ndermarre te gjitha reformat per sigurimin e nje procesi te drejte ligjor per cdo qytetar, akses te lehte ne drejtesi, drejtesi per te gjitha dhe barazi para ligjit te kujdo, trajtim njerezor ne paraburgim dhe shnderrimin e denimit penal ne nje mundesi ri-edukimi.

Liria e besimit

§ Mazhoranca e re vlereson se toleranca e shkelqyer fetare e shqiptareve, ne te gjitha koherat, eshte nje nga vlerat dhe kapitalet tona kombetare dhe shoqerore me te rendesishme.

§ Duke iu permbajtur me rigorozitet sekularizmit si parim fundamental i shtetit shqiptar qe ne krijim te tij, do te respektohet plotesisht liria e besimit

§ Qeveria angazhohet per nje kthim e kompensim te plote te pronave te komuniteteve fetare. Ne konsultim te ngushte me keto komunitete, si dhe me faktoret shoqerore e politike, qeveria do te studioje dhe promovojte alternativa te pershtatshme, ne formen e fondeve, instrumentave fiskale etj ne menyre qe te rritet mundesia e financimit te ketyre institucioneve me kontribute qytetare e publike.

ZBATIMI I PLOTE I LIGJIT- SHTETI LIGJOR

13. Dobesia e zbatimit te ligjit eshte nje nga problemet me te medha me te cilin perballen sot shqiptaret. Jo vetem per shkak te paaftesise per te kryer reforma por vecanerisht per shkak te mungeses se vullnetit si dhe per shkak te korrupsionit dhe konfliktit te interesave ne te gjitha nivelet, qeverisjet socialiste kane shkaktuar nje renie dramatike te forces se shtetit per te zbatuar ligjin kudo dhe ne menyre te barabarte per te gjitha, kane sjelle Shqiperine buze shtetit te falimentuar.

14. Per pasoje, krimet mbeten pa u ndeshkuar, te drejtat pronesore jane te pa-garantuara, kufijte e vendit jane poroze dhe lehtesisht te kalueshem per trafiket e trafikantet, korrupsioni u rrit ne permasa teper te rrezikshme duke u shnderruar ne sistem, tregjet rane nen kontrollin e monopoleve.

15. Nje zbatim ne keto nivele i ligjit ka sjelle pasoja mjaft negative per zhvillimin ekonomik, u ka ulur mundesine shqiptareve te gezojne te drejten e levizjes se lire si edhe ka vonuar perspektivat e integritit europian te vendit.

16. Mazhoranca e re dhe qeveria e saj ne projektin e tyre te ndryshimit zotohen per garantimin e barazise para ligjit dhe sundimin e ketij te fundit si kushti vendimtar per rivendosjen e shtetit ligjor, u ofrojne shqiptareve zbatimin e plote dhe te barabarte per te gjitha te ligjit. Per kete qellim krahas reformave te thella institucionale qeveria do t'i kushtojte vemendje disa drejtimeve themelore qe lidhen drejtperdrejt me rritjen e shkalles se zbatimit e ligjit:

LUFTA KUNDER KORRUPSIONIT- QEVERISJE ME DUAR TE PASTRA

iv) Mazhoranca e re dhe qeveria e saj shpall si prioritet absolut luftën për çmontimin dhe shembjen e strukturave të sistemit të korrupsionit. Brenda 100 ditëve të para të qeverisjes mazhoranca e re do t'u rikthejë shqiptarëve besimin se korrupsioni mund të luftohet me efektivitet dhe se të korruptuarit do të ndeshkohen. Morali qeverises i mazhorances së re është "Qeverisje me Duar të Pastra". Lufta kundër korrupsionit do të bazohet në kombinimin e dy drejtimeve themelore, atë të parandalimit dhe atë të ndeshkimit të korrupsionit:

Parandalimi i korrupsionit. Transparenca. Përfshirja

§ Reformat institucionale dhe ato të tregut do të kenë si komponent të përhershëm të tyre mjetet dhe metodat parandaluese që ngushtojnë hapësirat për korrupsion të tilla si transparenca, kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm, aksesit në vendimmarrje dhe roli monitorues i shoqërisë civile, komuniteteve vendore dhe të medias. Nderkaq, vetë kësaj reforme, duke ridimensionuar rolin e shtetit në ekonomi, duke ulur shkallën e burokracisë dhe të barrierave administrative, si dhe duke rritur rolin e sektorit privat dhe të atij terciar në ofrimin e të mirave publike, janë faktorë mjaft të fuqishëm në uljen e mundësive për korrupsion të zyrtarëve.

- Cdo institucion do të përshtatet dhe fuqizojë zyrat për informimin e publikut. Do të realizohet në praktike objektive "e-government". Çdo institucion, duke përdorur mjetet e teknologjisë së informimit dhe komunikimit do të ndërtojë shërbimin "on-line". Qytetarët do të kenë akses të lehtë dhe të plotë në gjithë veprimtarinë e qeverisë, nëpërmjet faqeve të internetit, nga ku do të informohen, do të marrin shërbime, do të shprehën dhe do të përfshihen në vendimmarrje.
- Do të amendohen ligji i konfliktit të interesit, ligji i prokurimeve publike, ai i koncesioneve dhe ligjet tjera të rëndësishme
- Qeveria do të përgatit bazën ligjore të veprimit të Ombudsmanit të Prokurimeve. Çdo ent prokurues do të ketë, paralel me njësinë e prokurimit, edhe garantin e procesit, Ombudsmanin e Prokurimeve. Ligji për këtë mekanizëm të kontrollit të procesit prokurues do të ofrojë mundësinë që ai të zgjidhet nga komuniteti i përfituesve, apo grupeve të interesuara konkurruese.
- Brenda një kohe të shkurtër do të rishikohen të gjitha procedurat e licensimeve. Ato do të standartizohen dhe thjeshtohen, në mënyrë që të lehtësohet nisja e lirë, apo shërbimi ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Institucionet do të ngrenë shërbimin e licensimit sipas parimit "një ndalim në një sportel".
- Qeveria do të angazhohet të zgjerojë dhe t'i japë një përmase të re bashkëpunimit me shoqërinë civile në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës. Institute dhe qendra studimore të konfirmuara për kapacitetet e tyre

profesionale dhe pavaresine e qendrimit, do te kontraktohen per te kryer studime dhe analiza te problemeve te korrupsionit. Nga ana tjeter, duke synuar qe te jete transparente ndaj publikut, Qeveria do te financoje me fondet e veta dhe ne bashkepunim me donatore te tjere, nje program grantesh per nisma qe synojne rritjen e transparences dhe forcimin e “vezhgimit qytetar e mediatik” mbi institucionet dhe zyrtaret. Kjo do te jete hera e pare qe qeveria paguan qytetaret dhe te interesuarit qe ta kontrollojne veprimtarine e saj. Ky do te jete nje shembull i seriozitetit dhe pergjegjshmerise se Qeverise ne luften kunder korrupsionit.

Ndeshkimi i korrupsionit

§ Veprimi ndeshkues ndaj rasteve korruptive do te jete nje perkushtim i perhershem i qeverisjes. Per kete qellim do te mobilizohet e gjitha forca institucionale dhe ligjore ne kompetence te qeverise per hetimin dhe ndeshkimin administrativ me masa disiplinore te cdo rasti te abuzimit me detyren, ose te korrupsionit nga ana e zyrtareve, si dhe do te kryhet kallzim penal pa asnje hezitim per cilindo zyrtar qe perfshihet ne korrupsion. Cdo iniciative e Prokurorise ne luften kunder korrupsionit do te gezoje mbeshtetjen e Qeverise dhe Mazhorances.

- Do te krijohet Task-Force Antikorrupsion e perbere nga perfaqesuesit e institucioneve kryesore shtetere, shoqeria civile, media dhe komuniteti i biznesit. Kjo strukture do te siguroje bashkepunimin e qeverise me te gjitha institucionet e tjera te pavarura te shtetit dhe aktoret e tjere te interesit.
- Qeveria do te pershtase strukturen qendrore ekzekutive pergjegjese per antikorrupsion dhe mireqeverisje e cila do te hartojte programin antikorrupsion, ndjeke zbatimin e tij, si edhe do t'i jape nje impuls te ri kontrollit te brendshem dhe ndeshkimit disiplinor te zyrtareve qe perfshihen ne praktika korruptive.
- Qeveria do te jete e vemendshme dhe do te reagoje menjehere ndaj ankimeve te publikut si edhe denoncimeve qe vijne nga mediat ose nga qytetaret. Per kete qellim do te funksionojne edhe linjat e komunikimit dhe denoncimit te qytetareve me qeverine qe garantojne edhe fshehtesine e burimit te informacionit.
- Ne vecanti, per zyrtaret me status politik, nuk do te ofrohet mbrojtje politike e te dyshuarve dhe do t'i hapet rruge procesit hetimor. Per kete qellim mazhoranca e re angazhohet se e gjitha trupa parlamentare e saj heq dore nga imuniteti dhe se do te rishikoje konceptin e imuniteteve sipas modeleve me te avancuara evropiane. Nuk mund te kete imunitet te zyrtareve kur ata kryejne krime ordinere vecanerisht te lidhura me korrupsionin.
- Ekipet qeverisese do te jene te cilruar nga konfliktet e interesave. Krahas amendimit te ligjit per parandalimin e ketyre konflikteve ne pikat e tij te dobeta, ai do te zbatohet plotesisht per te mbyllur cdo shteg te mundesive te shfrytezimit te pozites ne favor personal nga ana e zyrtareve. Qeveria do te mbeshtese me te gjitha mjetet e nevojshme veprimtarine e Inspektoriatit te Larte te Deklarimit dhe

Verifikimit te Pasurive.

RENDI PUBLIK. LUFTA KUNDER KRIMIT, TRAFIQEVE E TERRORIZMIT

v) Forcimi e garantimi i rendit e sigurise publike, individuale e komunitare do te perbeje angazhimin paresor te maxhorances se re e qeverise se saj. Motoja e Qeverise eshte: "Tolerance zero ndaj krimit".

Lufta kunder krimit te organizuar e trafiqeve

§ Lufta kunder krimit te organizuar, trafiqeve ne pergjithesi dhe atyre te droges e genieve njerezore ne vecanti, si dhe lufta kunder pastrimit te parave do te kene perparesi. Per kete qellim do te behen edhe ndryshime ligjore ne kodin penal per denime maksimale dhe nivel te prere denimi per keto vepra penale.

Angazhimi ne luften kunder terrorizmit

§ Shqiperia do te permbushe ne menyre aktive dhe te perkushtuar te gjithë detyrat dhe pergjegjesite e saj ne luften globale kunder terrorizmit si rreziku dhe armiku numer nje i paqes, sigurise dhe jetes se popujve.

Ulja e parandalimi i krimit ordiner

§ Krimi ordiner do te ndeshkohet por lufta kunder tij do te gershetohet edhe me masat efektive parandaluese. Qytetet, fshatrat, rruget, rrugicat, bankat e bizneset, lokalet dhe stadiumet dhe cdo cep i vendit do te jene teresisht te garantuara dhe siguria publike do te jete solide dhe e plote. Ne qytetet e medha do te investohet ne sistemet e monitorimit te panderprere elektronik.

§ Organet e rendit publik do t'i nenshtrohen nje reforme te thelle ne organizimin, shperndarjen, komandimin, marredheniet me komunitetin, pergatitjen profesionale dhe sigurimit te burimeve njerezore si dhe do te behen te afta te japin edhe sherbime speciale te sigurise.

Siguria rrugore

§ Siguria rrugore do te trajtohet gjithashtu me perparesi. Niveli i ulet i sigurise rrugore merr cdo vit me dhjetra jete njerezish dhe shkakton deme materiale te konsiderueshme. Krahas permiresimit te cilesise se rrugeve dhe sinjalistikës rrugore ne perputhje me standartet europiane, perfshire zbatimin e procedurave te auditimit te rrugeve qe nga momenti i projektimit e deri ne realizim, forcimi i dislines se qarkullimit rrugor, pajisa

me leje qarkullimi bazuar ne testim realiste dhe te pakorruptuara te drejtuesve te mjeteve nepermjet permiresimit te sistemit te autoshkollave, ristrukturimi i kontrollit teknik te mjeteve dhe edukimi masiv me rregullat e qarkullimit te te gjithe grupmoshave, vecanerisht te moshes shkollore, do te jene disa nga drejtimet kryesore. Policia rrugore ne bashkepunim me ate bashkiake do te jene jo vetem ndeshkuese te rasteve te shkeljes se rregullave te qarkullimit por ato do te shnderrohen ne institucione ne sherbim te qytetareve.

FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE E NJEREZORE PER ZBATIMIN E LIGJIT

vi) Zbatimi i ligjit kerkon rritje e fuqizim te kapaciteteve institucionale. Per kete qellim Qeveria do t'i kushtoje nje rendesi paresore rritjes se shkalles se profesionalizimit te zyrtareve si dhe permiresimit te teknologjise dhe mjeteve ne dispozicion ne cdo institucion e ne radhe te pare te atyre te rendit publik e te sistemit te drejtesise.

§ Ngritja profesionale e zyrtareve do te kombinohet me ristrukturime institucionale dhe me ngritjen e strukturave te specializuara e te mirepajisura me teknologji bashkekohore. Nderkaq do te fuqizohet shkalla e bashkeveprimit e bashkerendimit institucional.

§ Ne vecanti, ne lidhje me organet e rendit publik do te ndermerren reforma te vecanta si:

- Per te rritur kontrollin e kufijve tokesore, detare e ajrore do te kryhet nje integrim i Policise Kufitare me Policine e Rendit, me autonomine e nevojshme, si dhe nje bashkerendim efektiv i te gjitha institucioneve te tjera te rendit, mbrojtjes dhe sherbimit doganor e tatimor.
- Riorganizim territorial i shperndarjes se forcave te rendit per te mundesuar sigurine publike ne cdo njesi territoriale e ne vecanti ne ato pjese te vendit ose te zonave urbane me kriminalitet te larte.
- Reforma ne organet e rendit do te siguroje depolitizimin dhe spastrimin e radheve te ketyre organeve nga punonjes te korruptuar e te inkriminuar, riorganizimin e tyre, te marredhenieve te ketyre organeve me komunitetin, arsimimin, pajisjet dhe pergatitjen e tyre profesionale.

SISTEMI I INFORMACIONIT E DOKUMENTACIONIT

vii) Zbatimi i ligjit kerkon nje sistem modern te informacionit dhe dokumentacionit i cili i pergjigjet ne kohe reale dinamikes ekonomike dhe sociale, eshte i integruar, i sakte dhe lehtesisht i aksesueshem. Per kete qellim qeveria angazhohet per nje kompletim perfundimtar te regjistrave te dixhitalizuar te gjendjes civile, te pasurive, te tokes si dhe pajisjen perfundimisht te

shqiptareve me dokumentat baze te identifikimit, leternjoftim e pasaporte, te standarteve evropiane. Krahas ketyre sistemeve baze qeveria do te investoje vete ose ne bashkepunim me institucionet pergjegjese ne sisteme te tjera te informacionit si ato te krimit e investigimit, te deklaratave fiskale, te vendimeve gjyqesore, te qarkullimit te njerezve, te adresave etj.

SHTETI DHE ZYRTARET E TIJ - TE PARET QE ZBATOJNE LIGJIN

viii) Zbatimi i ligjit fillon nga vete shteti. Institucionet shteterore do te jene te parat qe do te respektojne detyrimet e tyre ligjore. Situata e sotme ku zyrtaret ndjehen mbi ligjin, imunitaret perdorin imunitetin per dhunimin e tyre, ku institucionet shteterore nuk zbatojne vendimet e formes se prere te gjykatave dhe nuk shlyejne detyrimet ndaj qytetareve dhe bizneseve do te marre fund. Zyrtareve te cdo institucioni shteteror do t'u kerkohet me shume se kujtdo zbatimi i ligjit.

QEVERIA NE BASHKEPUNIM ME INSTITUCIONET E PAVARURA PER ZBATIMIN E LIGJIT

ix) Qeveria brenda kuadrit kushtetues do te demonstroje te gjitha vullnetin pozitiv per te bashkepunuar me institucionet e tjera te pavarura me qellim rritjen e shkalles se zbatimit te ligjit. Ne vecanti bashkepunimi me prokurorine per ndeshkimin e krimit, me Inspektoriatin e Deklarimit dhe Verifikimit te Pasurive per te siguruar transparence dhe ndeshkim te korrupsionit dhe konfliktit te interesave, me Avokatin e Popullit per realizimin e te drejtave themelore te individeve dhe grupeve shoqerore dhe me qeverisjen vendore per te vendosur ligjin ne zhvillimin urban e mbrojtjen e mjedisit do te jene ne qender te vemendjes se qeverise.

BASHKEPUNIMI ME PARTNERET NDERKOMBETARE

x) Qeveria do te jete nje bashkepunetore e perkushtuar e partnereve nderkombetare ne luften kunder terrorizmit, krimit nderkufitar, krimit te organizuar, trafiqeve te te gjitha llojeve e pastrimit te parave dhe sigurise se kufijve. Ajo do t'i pergjigjet plotesisht dhe me efektivitet programeve te ndermarra nga partneret rajonale dhe nderkombetare ne keto fusha, do te respektojne angazhimet e marra dhe do te jete plotesisht e hapur per nje bashkepunim institucional dhe kapilar me institucionet e specializuara nderkombetare dhe te vendeve te tjera. Qeveria do te kerkoje jo vetem asistence por edhe nje veprimtari te perbashket te ketyre strukturave ne territorin shqiptar dhe rajonal. Bashkepunimi me shoqerine civile do te jete gjithashtu nje tjetër energji shtese qe do te shfrytezohet per te arritur suksese ne vendosjen e shtetit ligjor. Ne kuadrin e integritimit europian prioritet mbetet zhvillimi dhe zbatimi i Strategjise per Administrimin e Integruar te Kufijve sipas direktivave te BE-se.

EDUKIMI LIGJOR

xi) Edukimi ligjor do te marre nje rendesi te vecante per parandalimin e krimit dhe per zbatimin e ligjit. Qeveria do te ndermarre ose do te mbeshtese nisma te organizatave te ndryshme per nje

edukim masiv ligjor te te gjithë shtresave shoqerore duke filluar me permiresimin e ketij edukimi ne sistemin arsimor e deri ne rritjen e njohurive per ligjin ne administraten publike. Nismat e shoqerise civile, universiteteve e te komunitetit te juristeve ne kete fushe do te gjejne nje perkrahje te vecante.

ZHVILLIMI I SHPEJTE DHE I QENDRUESHEM EKONOMIK E NJEREZOR

17. Mireqenia ne rritje e cdo individi perben ne vetvete synimin me themelor te projektit te ndryshimit te mazhorances se re e te qeverise se saj. Ky synim mund te arrihet vetem nepermjet kryerjes se reformave te medha te krijimit te nje tregu konkurrencial e te hapur per iniciativen e lire qe prodhon mundesi per biznes apo punesim per kedo, bashkerenduar me reformat ne sektoret prioritare publike: rritjen e investimeve ne infrastrukture dhe energji, arsim dhe shendetesi si dhe e plotesuar me politika efektive sociale ne favor te grupeve shoqerore e individeve ne nevojë.
18. Rritja ekonomike e Shqiperise ka ardhur per shkak te energjise krijuese dhe sfiduese te shqiptareve qofte nepermjet iniciatives se lire si edhe nga nje mbeshtetje e pakursyer e partnereve nderkombetare. Por, tashme eshte e njohur se nje perqindje e konsiderueshme e kesaj rritjeje i detyrohet te ardhurave nga emigracioni, por fatkeqesisht edhe parave te trafikëve kriminale.
19. Nderkaq, reformat e munguara te qeverisjes socialiste, shkalla e larte e korrupsionit dhe e konfliktit te interesave ne te cilat ajo ishte perfshire kane cuar ne deformimin e konkurrences se lire dhe kapjen e ekonomise nga monopolet e ish-pushtetareve.
20. Programet e qeverive socialiste per zhvillimin ekonomik dhe social ose nuk u zbatuan ose u zbatuan ne menyre te deformuar. Per pasoje ritmet e rritjes ekonomike kane ardhur vazhdimisht duke u ulur dhe i ashtuquajtur stabilitet makroekonomik eshte teper i brishte.
21. Stanjacioni ne krijimin e vendeve te reja te punes dhe niveli i larte i papunesise, sipas definicionit ILO-s me shume se 38%, jane probleme te renda per shoqerine shqiptare. Investimet publike kane ecur me ritme teper te ngadalta dhe alokimi i tyre nuk eshte bere as ne perputhje me prioritetet, nevojat dhe shanset e zhvillimit dhe as ne menyre transparente e te drejte.
22. Varferia eshte ne nivele nga me te lartat ne Europe dhe risku i renies ne varferi eshte prezent dhe i larte per shtresa mjaft te gjera te popullsise te cilat ndodhen vetem pak mbi pragun e varferise absolute. Pabarazia eshte thelluar dhe prek jo vetem te varferit por edhe grupet e mesme shoqerore duke rritur pjesen e pasurise ne duar te pak njerezve.
23. Reformat e munguara ne arsim dhe shendetesi sebashku me pergjysmimin e buxhetit dhe me investimet jo-eficente ne keto dy sektore dhe keqadministrimin e tyre kane shkaktuar nje renie te pergjithshme te treguesve te arsimimit dhe te shendetit publik duke e forcuar efektin e tyre ne mundesine e renies ne varferi.
24. Shpenzimet shoqerore te qeverive socialiste kane ardhur ne renie te panderprere duke qene sot ne nivelin e gjysmes se mesatares se vendeve te rajonit te Ballkanit.

25. Rajonet e ndryshme te vendit kane thelluar zhvillimin e tyre te pabarabarte per shkak te politikave te deformuara dhe preferenciale ndersa politikat sociale kane mbetur inaktive dhe asistencialiste.
26. Mazhoranca e re dhe qeveria e saj me projektin e tyre te ndryshimit u ofrojne shqiptareve nje program vizionar dhe realist per futjen e vendit ne rrugen e zhvillimit te shpejte, te balancuar e te qendrueshem ekonomik dhe njerezor si rruga e vetme e rritjes se mireqenies se cdo individi ne baze te te ciles qendron puna dhe iniciativa e lire.
27. Zhvillimi i shpejte e i qendrueshem ekonomik e njerezor eshte njekohesisht kusht akselerues i procesit integrues te Shqiperise ne Bashkimin Europian. Nga ana tjeter, cdo progres ne procesin integrues do te thote nje perafirim me i plote i modeleve dhe standarteve europiane te tregut dhe nje afrim ne nivelet europiane te zhvillimit njerezor, te dy keto me efekte tejet pozitive ne zhvillimin e qendrueshem e te shpejte ekonomik e social
28. Synimi i qeverise eshte qe ekonomia shqiptare te rikthehet ne nivelet e larta te rritjes ekonomike rreth 6-8 % ne vit, bazuar ne nje ekonomi te lire, funksionale e institucionale tregu te modelit dhe standarteve europiane por njekohesisht nje rritje e tille nga e cila perfitojne ne menyre sa me te drejte te gjithë shqiptaret, rritje e cila eshte faktori kryesor i reduktimit te varferise, i rritjes se punesimit e reduktimit te papunesise deri ne nivelim mesatar te vendeve te zhvilluara europiane, si dhe nje rritje afatgjate qe nuk kompromenton shanset e brezave te ardhshem.
29. Njekohesisht, qeveria synon qe indeksi i zhvillimit njerezor te vendit te pesoje permiresime te ndjeshme dhe te pakthyeshme brenda periudhes 4- -vjecare duke iu afruar me shpejtesi mesatares se vendeve europiane.
30. Arritja e synimeve te mesiperme do te bazohet ne disa drejtime e politika prioritare si:

HAPJA E TREGUT. KONKURRENCA E LIRE DHE E NDERSHME

xii) Rivendosja e sistemit te tregut te lire e te konkurrences se ndershme, ne perputhje me normat dhe standartet europiane, do te perbeje bazen e qasjes se politikave ekonomike te projektit te ndryshimit te qeverise. Per kete qellim do te ndermerren reforma institucionale e ligjore si dhe do te ngrihen dhe/ose fuqizohen institucione te specializuara qe garantojne nje funksionim te tille te tregut. Politikat qeveritare do te synojne thellimin e hapjes ekonomike nepermjet liberalizimit te ekonomise duke respektuar angazhimet e ndermarra ne kuadrin e OBT-se, te marreveshjeve te tregtise se lire me vendet e rajonit dhe te projekt-marreveshjes se stabilizim asociimit me BE-ne. Po keshtu reformat ne tregun e brendshem do te orientohen drejt rritjes se konkurrueshmerise se ekonomise shqiptare ne ate globale. Reformat institucionale dhe te zbatimit te ligjit do te kene ne teresi ndikime pozitive ne drejtim te garantimit te lirise se tregut dhe te konkurrences se ndershme. Gjithashtu, do te synohet nje ngushtim gradual i peshes se sektorit informal. Ne lidhje me hapjen e tregejve dhe garantimin e konkurrences se lire e te ndershme do te ndermerren disa politika dhe programe drejtperdrejt te lidhura si:

Garantimi i te drejtave pronesore e tregtare

§ Qeveria do te ndermarre permiresime ligjore dhe institucionale per garantimin e te drejtave te pronesise, perfshire ate intelektuale e te patentave e markave tregtare. Regjistrat e te drejtave pronesore do te informatizohen dhe institucionet pergjegjese do te fuqizohen per te garantuar respektimin e tyre.

Konkurrenca e lire dhe anti-monopoli

§ Do te ndermerren permiresime ligjore dhe institucionale per garantimin e konkurrences se lire vecanerisht ne tregjet me tendence te natyrshme monopol. Ne vecanti do te kerkohet nje veprimtari e pergjegjshme dhe efektive e enteve rregullatore, te cilat gjithashtu do te reformohen, si dhe do te nxitet rritja e numrit te operatoreve qe veprojne ne keto tregje.

Te drejtat e konsumatorit

§ Do te realizohen permiresime ligjore dhe institucionale per te ndaluar abuzimet me cilesine e mallrave dhe sherbimeve dhe duke garantuar njekohesisht te drejtat e konsumatorit.

Reduktimi i barrierave administrative

§ Uljen e barrierave administrative per nisjen dhe kryerjen e bizneseve duke kombinuar nga nje ane reduktimin, thjeshtezimin dhe qartesimin e procedurave administrative te dhenies se lejeve dhe autorizimeve per aktivitetet ekonomike te cdo fushe, me ngritjen e qendrave te sherbimit "nje ndalim ne nje sportel" me nje sportel per bizneset shqiptare dhe te huaja.

§ Zbatimin dhe kontrollin e zbatimit te ndershem e te barabarte te standarteve, kriterëve dhe procedurave per cdo biznes nga cdo institucion shteteror.

Informacioni ne sherbim te tregut te lire

§ Kryerjen e investimeve te medha publike ne sistemet e informacionit si dhe nxitje dhe/ose perfshirje e sektorit privat ne sherbimin e informimit qe ndihmon dhe lehteson funksionimin e tregjeve dhe te lidhjes se tyre ne kohe reale. Funksionimi i tregjeve dhe sjellja rationale e operatoreve do te mbeshtetet edhe nga perhapja ne shkalle te gjere dhe konsultimet qe do te kryhen mbi politikat publike ne cdo fushe.

Partneriteti publik- privat bazuar ne rregullat e tregut te lire e te konkurrences se ndershme

§ Qeveria do te ndermarre nisma ligjore per permiresimin e sistemit te bashkepunimit publik-privat. Shkalla, llojshmeria dhe masa e ketij partneriteti do te rriten maksimalisht. Privatizimi i sektoreve strategjike, duke perdorur edhe letrat me vlere, perfshirja e sektorit privat ne ofrimin e sherbimeve te natyres publike te te gjitha llojeve nepermjet koncensioneve, kontratave e prokurimeve do te jene instrumentat kryesore qe do te perdoren per kete qellim. Nga ana tjetere, qeveria do t'i jape fund perdorimit te ketyre mjeteve per te deformuar konkurrencen dhe per te diskriminuar bizneset. Partneriteti publik-privat do te realizohet teresisht ne perputhje me parimet e tregut te lire e te konkurrences se ndershme.

ZHVILLIMI I TREGUT BANKAR E FINANCIAR. RRIJJA E KREDITIMIT

xiii) Ne bashkepunim me Banken e Shqiperise, qeveria do te ndermarre nisma ligjore dhe institucionale per nje fuqizim te shpejte dhe te qendrueshem te sektorit bankar e financiar. Disa nga masat kryesore qe do te ndermerren do te shtrihen ne:

Mbikqyrja dhe rregullimi i sektorit financiar

§ Do te forcohet autoriteti i luftes kunder pastrimit te parave te pista me origjine nga trafiqet ilegale dhe terrorizmi si dhe per dekriminalizimin e aktivitetit ekonomik ne vend. Ne kete menyre do t'i sherbehet rritjes se besueshmerise per vendin dhe sistemin e tij ekonomik e ligjor. Forcimi i ketij autoriteti do te kete vemendjen kryesore per ta shnderruar ne nje institucion qe funksionon normalisht dhe ka rezultate. Ndihma e partnereve nderkombetare ne kete drejtim do te kerkohet pa hezitim.

§ Do te pershpjtohen hapat per perafrimin e procesit mbikqyres dhe rregullativ me standartet nderkombetare per te rritur qendrueshmerine e sektorit financiar shqiptar.

§ Do te realizohet integrimi ne nje autoritet te vetem i enteve te ndryshme te rregullimit dhe mbikqyrjes se sektorit financiar. Qellimi eshte qe te sigurohet nje standart i perafert mbikqyrjeje dhe rregullimi ne te gjitha segmentet e sektorit financiar.

Tregu bankar dhe rritja e kreditimit

§ Permiresimi i kuadrit ligjor per aktivitetin bankar, sebashku me efektet e politikave ne drejtimet e tjera te programit qeverises, te tilla si zbatimi i ligjit, garantimi i te drejtave te pronesis, reduktimi i deficitit fiskal, do te ulin riskun e kredise dhe do te rrisnin potencialet kredituese te bankave duke synuar brenda periudhes 4-vjecare nje tre-katerfishim te kredise per sektorin privat. Masa te tjera ligjore, institucionale dhe kontraktore me sistemin bankar do te sjellin uljen e perdorimit te cash-it ne ekonomi dhe qarkullimin me te madh dhe me te shpejte te parase nepermjet bankave.

Zgjerimi i mikrokredise

§ Qeveria do të mbeshtese shtimin, zgjerimin dhe forcimin e skemave të mikrokredise qofte të atyre që veprojnë si fondacione me pjesëmarrje të shtetit qofte ato të ngritura nga partneret nderkombetare duke i orientuar ato vecanerisht në drejtim të bizneseve në sektore me efekte punesimi si dhe për biznese në rajonet me pak të zhvilluara të vendit. Sistemi i mikrokredise do të adoptoje, sipas rastit dhe pa demtuar thelbin e konkurrencës së lire, edhe skema të garantimit të kredive ose të kredive me interesa të buta. Në fund të periudhës 4-vjecare synohet që aftësia mikrokredituese të tre-katërfishohet ndërsa institucionet e mikrokredise do të kalojnë në forma më të qendrueshme si institucione të kursim-kreditit, banka zhvillimi rural dhe forma të tjera.

Tregu i kapitaleve dhe Bursa e Tiranës

§ Do të fillojë funksionimi i tregut të kapitaleve nëpërmjet rivenies në punë, të Bursës së Tiranës duke parë mundësinë për shndërrimin e saj në kohë të përshtatshme por sa më të shpejtë në një institucion privat. Për këtë qëllim do të kalojë në burse tregtimi i obligacioneve afatgjata të thesarit si dhe tregtimi i një pjese të aksioneve shtetërore të kompanive publike. Në bashkëpunim me Komisionin e Letrave me Vlerë, Bursa e Tiranës do të ndermarre edhe fushata ndergjegjesimi dhe informimi për bizneset ndërsa rritja e disiplinës financiare dhe fiskale do të shërbejë gjithashtu për nxitjen e kuotimit në burse të sektorit privat.

Tregu i sigurimeve

§ Qeveria do të ndermarre nisma ligjore dhe institucionale për garantimin e konkurrencës së lire dhe të funksionimit transparent e të ndërsheëm të tregut të sigurimeve. Do të mbeshtetet fuqizimi i autoritetit rregullator të këtij tregu. Do të luftohet korrupsioni dhe lidhja e kontratave mes institucioneve shtetërore dhe operatoreve të këtij tregu të infektuara nga konfliktet e interesave. Do të privatizohet pjesa shtetërore e INSIG.

REDUKTIMI I PESHES SE EKONOMISE INFORMALE

xiv) Informaliteti i ekonomisë ka arritur në nivele shqetësuese duke përbërë një faktor rrisht dhe pasigurie për zhvillimin ekonomik të vendit. Vlerësohet që raporti i aktivitetit informal përkundëjt atij formal në sferën e biznesit privat arrin në kufinj të 140%. Qeveria vlerëson se faktorë të fuqishëm nxitës të informalitetit janë shkalla e lartë e burokracisë, barrierat e konsiderueshme administrative, barra e lartë fiskale dhe vecanerisht korrupsioni, diskriminimi fiskal dhe monopolizimi i tregjeve.

§ Programi i qeverisë i lidhur me hapjen e tregut, deburokratizimin e reduktimit e

barrierave administrative e te barres fiskale, zhvillimi i sektorit finaciar e mikrokredise, zgjerimi i sherbimeve te informimit dhe sherbimeve te tjera ne favor te biznesit krahas efekteve ne zhvillimin ekonomik do te sjellin edhe uljen e shkalles se informalitetit te ekonomise.

§ Gjithashtu, forcimi i disiplines fiskale, zbatimi i plote i ligjit, lufta kunder korrupsionit, trafiqeve e pastrimit te parase do te sjellin gjithashtu efekte ne reduktimin e ndjeshem te asaj pjese te ekonomise informale qe eshte e zeze dhe kriminale.

SHQIPERIA: VENDI ME ATRAKTIV PER INVESTIMET E HUAJA

xv) Si pasoje e dëmtimit të rëndë e të klimës së biznesit, për shkak të pengesave të konsiderushme administrative, korrupsionit të përhapur dhe kapjes së shtetit, dobësive kronike regullatore të qeverisë si dhe riskut të perceptuar politik të vendit, etj, trashëgimia socialiste në këtë fushë është ajo e vendit me nivelin më të ulët në rajon dhe ndër vendet në tranzicion në investimet private, financimet e huaja direkte (FDI) dhe eksportet. Terheqja e investimeve të huaja është e një rëndësie vendimtare për sigurimin e ritmeve të larta për zhvillimin dhe integrimin e vendit. Programi i ndryshimit i mazhorances së re dhe qeverisjes së saj, bazohet në moton - "Shqipëria vendi me atraktiv për investimet e huaja në rajon e me gjere".

§ Arritja e objektivave të demokracisë dhe shtetit ligjor, të luftes kundër korrupsionit dhe trafiqeve, përbejnë kushtin baze për krijimin e premisave për terheqjen e investimeve të huaja.

§ Tregu i lirë dhe me rregulla, eliminimi i barrierave administrative, progresi në infrastrukturë dhe zhvillimi i burimeve njerëzore, zgjerimi, e vecanerisht modernizimi i sektorit financiar, stabiliteti makroekonomik janë po aq të rëndësishëm për të krijuar një mjedis të pershtatshëm për rritjen e masës së investimeve të huaja.

§ Ofrimi i lehtësirave në formën e parqeve industriale, lehtësirave fiskale, lehtësimit të partneritetit me biznesin vendas, si dhe pasurimi e intensifikimi i informacionit mbi mundësitë për biznese në Shqipëri do të jenë disa nga programet specifike për nxitjen e investimeve të huaja.

§ Fuqizimi i kapacitetit regullator mbi tregun, vendosja e konkurrencës dhe eliminimi i informalitetit në ekonomi, garantimi i të drejtave pronësore e zgjidhja e konflikteve të trashëguara, liberalizimi i procedurave për hyrjen në treg dhe integrimi më i shpejtë me tregjet rajonale e të BE, do të mundësojnë që në 4 vitet e ardhshme gjysma e nevojave për investime të ekonomsë shqiptare të përballohen nga FDI

GARANTIMI I STABILITETIT MAKROEKONOMIK

xvi) Funkcionimi i tregut do te mbeshtetet nga nje stabilitet makroekonomik i qendrueshem i cili do te bazohet ne politika te sukseshme fiskale e monetare permes nje bashkepinimi efektiv me Banken e Shqiperise e qe do te siguroje punesim te plote.

Ulja e deficit buxhetor dhe e borxhit publik

§ Qeveria angazhohet qe te ule deficitin buxhetor nepermjet rritjes se te ardhurave fiskale dhe manaxhimit me efektivitet dhe eficience te shpenzimeve publike. Ne fund te periudhes 4- -vjecare synohet qe deficitin buxhetor te mos jete me i larte se 4% e PBB-se.

§ Borxhi publik do te perdoret vetem per te mbuluar nevojat per investime publike ndersa te ardhurat nga privatizimet e pasurise kombetare do te perdoren vetem per investime publike ne sektore prioritare dhe me efekte zhvilluese.

Norma e pershtatshme vjetore e inflacionit

§ Duke mbeshtetur Banken e Shqiperise, qeveria nepermjet politikave eficiente fiskale dhe buxhetore do te kontribuojte ne mbajtjen ne kufij te pershtatshem 2-4% te inflacionit mesatar vjetor.

Treguesit e tjere makroekonomike

§ Permiresime te ndjeshme do te arrihen edhe ne tregues te tjere makroekonomike si ne deficitin e Llogarise Korrente, deficitin tregtar, punesimin, rritjen e peshes se kursimeve dhe investimeve ne raport me PBB-ne, etj. Ne fund te periudhes 4- -vjecare synohet qe pesha e investimeve publike dhe private ne raport me PBB te arrije nivelin e rreth 30% te PBB-se nga rreth 20% qe eshte sot. Investimet publike me burime te brendshme do te arrijne ne mbi 5% te PBB-se, nga 2% qe jane aktualisht.

POLITIKAT DHE ADMINISTRIMI FISKAL

xvii) Ne projektin e ndryshimit te qeverise politikat fiskale dhe sistemi tatimor do te shnderrohen ne instrumenta ne funksion te zhvillimit ekonomik ndersa administrata tatimore e doganore do te unifikohet me nje institucion te vetem dhe do te shnderrohet nga nje mekanizem i nderhyrjes deformuese ne treg dhe mjet korrupsioni dhe evazioni ne nje sherbim te integruar publik te te hyrave fiskale me nje sjellje shembullore sherbyese, kooperuese dhe ndihmuese per bizneset

dhe qytetaret tatimpagues. Ne fund te periudhes 4- -vjecare synohet qe te ardhurat buxhetore te arrijne ne nivelin 28-30% te PBB.

Sherbimi i te hyrave publike. Administrimi fiskal. Disiplina, transparencja, thjeshtesia dhe ndershmeria fiskale.

§ Forcimi i disiplinës tatimore dhe zbatimi i drejte, i ndershem dhe eficient i procedurave tatimore e doganore ne kombinim edhe me decentralizimin fiskal do te jene mjetet kryesore si per reduktimin e evazionit fiskal ashtu edhe per eliminimin e nderhyrjes deformuese te administratave shteterore ne tregje dhe te diskriminimit te tatimpaguesve per shkaqe politike dhe/ose korruptive.

- Procedurat tatimore do te thjeshtohen dhe qartesohen, sherbimet e administrates tatimore do te behen me te lehta dhe me te shpejta nepermjet teknologjise se informacionit, sherbimit ne nje sportel, zgjerimit te perfshirjes se sistemit bankar si dhe nepermjet nje reforme organizative dhe forcim te kapaciteteve njerezore ne organet e administrates tatimore dhe doganore.
- Organet tatimore dhe doganore do te riorganizohen sipas nje modeli te integruar te te hyrave publike si nje bashkim i te gjitha trupave qe administrojne deri me sot te ardhura publike, perfshi kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore;
- Vendosja e rregullave transparente ne rekrutimin, ngritjen ne detyre e shkarkimin e punonjesve ne perputhje me rregullat baze te Sherbimit Civil, Kodit Doganor dhe Ligjit per Administrimin dhe Procedurat Tatimore.
- Rishikimi i Kodit te Etikes, ngritja e sherbimit te standarteve profesionale e morale, si dhe ngritja e strukturave antikorrupsion brenda sherbimit te te hyrave.
- Ngritjen e instancave apeluese per te garantuar mbrojtjen e tatimpaguesve ne dy nivele: nje brenda Sherbimit te te Hyrave dhe nje tjeter te pavarur nga ekzekutivi shqiptar, ne formen e nje "Tribunali Tatimor", si shkalle e fundit e ankimit administrativ;
- Prezantimin e procedurave te reja per identifikimin e subjekteve, deklarimin, vetevleresimin, vleresimin tatimor, mbledhjen e detyruar etj.
- Futjen e vetedeklarimit per çdo tatim te veçante ne analogji me TVSH-ne nepermjet formave te thjeshta e te kuptueshme per te gjithë tatimpaguesit.
- Informatizimi dhe lidhja ne nje rrjet te vetem i te gjitha pikave hyrese me zyrat tatimore brenda territorit te vendit.
- Do te vendosen nen autoritetin e plote ligjor te Sherbimit te te Hyrave magazinat doganore e tatimore duke i dhene fund trajtimeve preferenciale politike.

- Aplikimin ne praktike te te gjitha marreveshjeve dhe traktateve per eleminimin e tatimeve te dyfishta dhe per shkembimin e informacionit ne lufte kunder evazionit me vendet fqinje.
- Komuniteti i biznesit do te konsultohet gjeresisht per keto reforma si dhe do te krijohen lehtesira per ankimin administrativ dhe marrjen e informacionit e ankesave te bizneseve ndaj veprimeve abuzive te zyrtareve te ketyre organeve.
- Ne kuadrin e decentralizimit te thelle fiskal, Qeveria do te mbeshtese krijimin dhe/ose forcimin e administrates tatimore vendore te bashkive dhe komunave dhe do bashkepuoje me kete administrate per nje reformim teresor te sjelljes e disiplinës fiskale si te administrates ashtu edhe te bizneseve dhe te qytetareve.
- Edukimi fiskal i publikut do te marre nje rendesi te vecante. Per kete do te iniciohen programe edukative si dhe do te prodhohen guida dhe materiale te tjera informative. Qytetaret dhe bizneset do te informohen per te drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore.

Me pak taksa - shkalle tatimore me te uleta

§ Politikat fiskale te qeverise do te bazohen ne parimin « me pak taksa, me shume biznes e punesim por edhe me shume te ardhura buxhetore ». Numri i madh dhe niveli i sotem i tatimeve dhe taksave sebashku me nje zbatim te deformuar dhe korruptiv te tyre eshte shnderruar ne nje faktor mjaft negativ dhe barriere e larte ne zhvillimin ekonomik te vendit.

- Qeveria do te reduktoje numrin e taksave dhe do te ule progresivisht shkallet tatimore ;
- Do te rishikohet i gjithe sistemi tatimor duke synuar nje taksim sa me uniform mes pasurise, te ardhurave dhe konsumit si tre shtyllat baze te taksimit modern.
- Do te ulet tatimi mbi fitimin e shoqerive ne 20%. Me synim nxitjen e punesimit, ky tatim do te ulet edhe me tej respektivisht me 20% per fitimin e riinvestuar, per subjektet qe rrisin punesimin, si dhe per eksportuesit; Gjithashtu do te aplikohet perjashtimi nga tatim-fitimi per nje periudhe 1-3 vjecare per bizneset e reja me kusht qe te rrisin punesimin; Do te njihet nje nivel prej 10% shpenzim i zbritshem per teknologjine e re pervec amortizimit te vitit korrent si dhe do te perdoren shkalle me te pershtatshme amortizimi per efekt te llogaritjeve te kostove te zbritshme. Do te pranohet vetevleresim nga subjektet tatimpagues per kestin e paradhenies me

kusht qe masa e gabimit te mos jete mbi nje nivel te caktuar .

- Politika te lehtesuara ne lidhje me tatimin mbi te ardhurat do te ndiqen edhe per bizneset e vogla te hapura rishtaz dhe per te vetepunesuarit. Barra fiskale per keto biznese mesatarisht do te pergjysmohet. Diferencimet per keto bizneset do te adoptohen duke patur parasysh edhe kushtet specifike ne rajone te ndryshme te vendit. Te gjitha taksat e lidhura me biznesin e vogel do te percaktohen me ligj si taksa vendore. Bashkite dhe komunat do te autorizohen me ligj qe te percaktojne vete regjimin fiskal te ketij biznesi, do te mbledhin vete te ardhurat por edhe do te mbeshteten nga administrata qendrore ne kete proces te rritjes dhe aftesimit.
- Do te ulet ne nivelin e 35% detyrimi per kontributet shoqerore me synim uljen e kostove per punedhenesit si edhe nxitjen e metejshme te punesimit. Krahas kesaj uljeje do te perdoren edhe programe te tjera te nxitjes se punesimit.
- Tatimi mbi vleren e shtuar do te ulet nga 20% qe eshte sot ne 17%. Do te adoptohet nje shkalle e dyte tatimore prej 6% vetem per furnizimet me energji elektrike si dhe do te zgjerohet shporta e TVSH 0% per furnizimet e sherbimeve te edukimit, barnat dhe sherbimet mjeksore ; furnizimet per mediat dhe furnizimi i gazit te lengshem.
- Tatimi mbi te Ardhurat Personale do te prezantohet si nje tatim gjithepershires mbi bazen e vetdeklarimit vjetor. Shkallet tatimore do te jene progresive ne baze te nivelit te te ardhurave. Shkalla maksimale do te jete 20% nga 23% qe eshte sot.
- Do te thjeshtohet lista e mallrave te akcizueshem, do te zbutet shkalla tatimore duke e uniformizuar ate ne nivele jo me te larta se ato te rajonit me efekte pozitive edhe ne dekurajimin e kontrabandes.
- Taksat Doganore do te njohin ulje te metejshme ne kuadrin e te gjitha Marreveshjeve te Tregtise se Lire, Marreveshjes Tregtare me BE dhe anetaresimit ne OBT.

PRIORITETET E ZHVILLIMIT DHE SHPENZIMET BUXHETORE

31. Hartimi i strategjive komplekse per zhvillimin ekonomik e social si dhe i disa strategjive sektoriale ose per fusha prerese e kompkesë i mundesuar nga kapacitetet ekzistuese shqiptare dhe mbeshtetja e donatoreve te rendesishem nuk eshte shoqeruar me vullnetin e nevojshem politik dhe struktura e mekanizma adekuate per te zbatimin e tyre. Ky i fundit eshte ne nivele teper te ulta dhe shumica e strategjive te hartuara jane te bllokuara dhe jane perdorur vetem per demagogji dhe per te krijuar imazhin e rreme te perpjekjeve per rritjen e eficences dhe efektivitetet te financave publike.

32. Objektivat dhe qasjet strategjike te dokumenteve te shumta strategjike nuk jane konsideruar dhe mbeshtetur nga programi i shpenzimeve publike dhe si rezultat alokimi i fondeve buxhetore eshte bazuar ne interesa te ngushta personale dhe elektorale dhe jo ne perputhje dhe ne sherbim te permbushjes se synimeve dhe objektiveve strategjike.

33. Mungesa e vullnetit politik, korrupsioni, kapja e shtetit dhe interesat e ngushta politike kane bere qe shperndarja e fondeve te jete e padrejte dhe te krijohen shperpjestime me pasoja afatgjata sektoreve te sherbimeve publike dhe rajoneve te vendit. Shembulli me i qarte i ketyre shperpjestimeve eshte sektori i arsimit i cili eshte shpallur si nje objektiv madhor dhe paresor ne programet dhe kornizen afatmesme buxhetore te qeverisjes socialiste, ndersa fondet buxhetore te alokuara per kete sektor ne raport me PBB zene nje peshe specifike relativisht te vogel dhe kane ardhur ne ulje nga njeri vit ne tjetrin.

34. Shpenzimet buxhetore nen qeverisjet socialiste kane rene ne menyre te ndjeshme nga 30-32 % te PBBs ne 28% te saj, si pasoje e pamjaftueshmerise se te hyrave ne buxhet. Renia me e madhe e shpenzimeve lidhet me shpenzimet kapitale dhe ato shoqerore duke mbetur ne nivelin e me pak se gjysmes se vendeve te rajonit.

BUXHETIMI BAZUAR NE PRIORITETE. TRANSPARENCA DHE PJESEMARRJA. ADMINISTRIMI I SHPENZIMEVE PUBLIKE.

xviii) Qeveria ne projektin e saj te ndryshimit do t'i alokoje fondet publike te brendshme dhe te huaja ne perputhje me prioritetet e percaktuara ne dokumentet e strategjise se zhvillimit kombetar e te procesit te integritimit europian. Brenda sektoreve, per alokimin e fondeve publike do te merret ne konsiderate masa dhe ndikimi i shpenzimeve publike ne arritjen e objektiveve te zhvillimit dhe integritimit. Krahas ketyre efekteve paresore, do te konsiderohen edhe nevojat per lehtesimin e problemeve sociale te grupeve ne nevojte nepermjet instrumentave aktive te integritimit te tyre ne jeten shoqerore dhe ekonomike. Si rezultat i rritjes se te hyrave si dhe nje thithjeje me te larte te fondeve nga burime te huaja ndihme dhe kreditimi, shpenzimet totale publike ne fund te periudhes 4-vjecare synohet te arrijne ne nivelin e 33-35% te PBB-se.

§ Qeveria do te reformoje thellesisht sistemin e planifikimit te financave publike, nepermjet zbatimit te Sistemit te Planifikimit te Integruar i cili do te siguroje harmonizimin e zhvillimit te buxhetit vjetor me Kornizen Afatmesme te Planifikimit Buxhetor si dhe me Strategjine Kombetare te Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Procesin e Stabilizim Associmit dhe strategji e politika te tjera prioritare.

§ Permirosimi i sistemit te planifikimit do te shoqerohet me krijimin e nje sistemi eficient te menaxhimit financiar, te kontrollit, te raportimit dhe te auditimit te shpenzimeve publike. Efektiviteti i ketyre sistemeve do te matet me permbushjen e objektiveve te programuara

§ Pergatitja e buxhetit do te kryhet detyrimisht brenda afateve ligjore, do te jete e plotesuar me analiza dhe argumenta makroekonomike te objektiveve fiskale, te qendrueshmerise buxhetore e fiskale dhe do te kaloje ne nje proces te hapur debati publik para e gjate atij parlamentar, ku do te perfshihen te gjithe aktoret e interesuar.

§ Sistemi i reformuar i financave publike do te garantoje:

- Optimizimin e madhësisë së qeverisë dhe të administratës publike, duke vendosur standarde në krijimin e strukturave administrative dhe të shpenzimeve për të bazuar në produktet (Output) dhe rezultatet (outcome) që do të arrihen dhe duke synuar kufizimin e shpenzimeve në formën e pagesave apo të shërbimeve administrative me efektivitet të ulët.
- Rritjen e qëndrueshme të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe të funksionimit të shërbimeve direkte publike për një përmirësim të qëndrueshëm të cilësisë së tyre
- Rritjen me përparësi dhe në mënyrë progresive të shpenzimeve kapitale të investimeve publike, për të arritur në nivelin 5% të PBB nga burime të brendshme në vitin 2008.
- Uljen e shpenzimeve të huamarrjes si rezultat i uljes së deficitit në përqindje të PBBsë PBB. Kjo do të sigurojë çlirimin e një pjese të burimeve për t'u përdorur për financimin e investimeve prioritare publike
- Stabilizimin në mënyrë graduale të bilanceve primare dhe korente për të siguruar mbulimin e shpenzimeve për interesa dhe për rritjen e financimit të investimeve publike nga të ardhurat fiskale të qëndrueshme.
- Krijimi i kushteve, në këto mënyra, për kalimin gradual nga grantet dhe kreditë kondicionare të donatoreve në kredi tregëtare.

35. Disa nga fushat prioritare që qeveria i konsideron si determinante për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik e njëzëz të vendit dhe për të cilat do të alokohen pjesa kryesore e shpenzimeve publike janë:

ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

xix) Në projektin e ndryshimit të mazhorancës së re dhe qeverisë së saj, zhvillimi i një infrastrukture moderne që e integron vendin me rajonin dhe me Europën konsiderohen si kusht baze për sigurimin e rritjes së synuar ekonomike dhe për zhvillimin në teresi të vendit. Qeveria do të forcojë kapacitetet projektuese dhe zbatuese të projekteve infrastrukturore, do të rrisë ndjeshëm alokimin e shpenzimeve publike në këto fushë si dhe do të demonstrojë aftësi të larta për fitimin e besimit të partnerëve ndërkombëtarë, veçanërisht të BE-së, BEI, EBRD etj., për të rritur masën e financimit grant të kombinuar me kredi nga ana e tyre.

Transporti, rruget, portet dhe aeroportet

§ Objektivi strategjik për sektorin e transportit është krijimi gradualisht i një hapsire unike e të lidhur qarkullimi si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel rajonal dhe evropian. Strategjia e transportit do të ketë në baze udhëzimet dhe kushtet e politikave të transportit të BE-së. Politikën e qeverisë do të konsiderojnë optimizimin e elementeve

te dobishem te transportit si shpejtesia dhe komoditeti i levizjes perkundrejt ndikimit negativ mjedisor dhe sigurise ne levizje. Per kete qellim, infrastruktura rrugore, portuale dhe aeroportuale do te terheqin pjesen me te madhe te investimeve me burime publike dhe donatore. Krahas tyre do te eksplorothen forma te sigurta te terheqes se kapitalit privat si ne investim ashtu edhe ne shfrytezim e mirembajtje:

- Vazhdimi i korridoreve lindje-perendim dhe veri-jug, me perparesi segmentin e rruges Lushnje-Vlore, ndertimi i autostrades Durres-Prishtine dhe boshtit qendror te jugut, zgjerimi i kapaciteteve te porteve te Durresit, Vlores, Sarandes, Shengjinit sipas destinacionit me te pershtatshem te tyre jane prioritetet kryesore te qeverise ne 4 vitet e ardhshme. Krahas tyre do te fillojne punimet ose do te pergatiten projektet edhe per segmente te tjera te rendesise kombetare.
- Integrimi i rajoneve te ndryshme te vendit eshte po aq i domosdoshem sa edhe ai i integritimit ne tregjet rajonale e globale. Per kete qellim, do te alokohen fonde te konsiderueshme per investime ne rrjetin kombetar e rajonal te rrugeve, efektet e te cilit do te jene nje akses me i larte i rajoneve me pak te zhvilluara ne tregun kombetar e me gjere, qe do te sjelle nje rritje te shanseve per nje zhvillim me te balancuar ne te gjithe territorin.
- Ne bashkepunim me pushtetin vendor e ne respekt te plote te autonomise vendore, qeveria do te financoje permiresimin e infrastruktures rrugore te bashkive dhe komunave. Ne vecanti ne 4 vitet e ardhshme do te kryhet shtrimi e asfaltimi i 4000 km rruge rurale me efekte te shumefishuara ne uljen e varferise dhe rritjen e mundesive per zhvillim te zonave rurale e malore te vendit.
- Qeveria do te zbatoje me eficence projektet aeroportuale per rritjen e kapaciteteve te qarkullimit si dhe do te zbatoje metodat me efektive te terheqes se kapitaleve private ne keto sherbime.
- Plotesimi i standarteve europiane te transportit dhe ngritja e strukturave koordinuese e homologe me ato europiane do te krijojne kushtet edhe per nenshkrimin e konventave dhe marreveshjeve ne te gjitha fushat e transportit.

Sigurimi i ujit te pijshem per cdo familje

§ Furnizimi me uje te pijshem dhe largimi e trajtimi i ujrave te zeza eshte gjithashtu nje prioritet madhor i qeverise per te cilen do te alokohen fonde te konsiderueshme per investime dhe mirembajtje. Decentralizimi, komercializimi dhe privatizimi do te perbejne elementet themelore te metodës se futjes ne treg te ketij sektori dhe mundesimin e rritjes se cilesise dhe sasise se ofertes se ketij sherbimi

- Qeveria do te marre masa te forta per te disiplinuar me mjete ligjore shperdorimin e ujit te pishem, rritjen e disiplines financiare dhe menaxheriale te shoqerive te ujesjellesave, reduktimin e humbjeve te tyre dhe uljen e deri ne zero te subvencioneve per shpenzime operative. Qeveria do te terheqe fonde te konsiderueshme nga partneret nderkombetare per investime themelore ne

teknogjine e ujesjellesave e te trajtimit te ujrave te zeza e ne sistemin e kanalizimeve.

- Brenda vitit te pare te qeverisjes, per sezonin turistik 2006, qytetet turistike qe nga Saranda deri ne Velipoje do te kene uje 24 ore dhe ne vitet ne vijim ky nivel do te arrihet ne te gjitha bashkite e vendit bashkeshoqeruar me permiresime te prekshme te ketij sherbimi ne zonat rurale.
- Brenda vitit te pare te qeverisjes do te perfundoje transferimi i plote i te drejtave te pronesis mbi sistemin e ujesjellesave dhe kanalizimeve tek pushtetet vendore duke zgjidhur ne favor te tyre edhe ceshtjet e borxheve, humbjeve, subvencioneve dhe financimeve per investime. Qeveria do te mbeshtese plotesisht bashkite dhe komunitat qe te rrisin cilesine dhe sasine e ketij sherbimi ne menyre autonome njekohesisht duke i nxitur ato qe te arrijne gradualisht te mbulojne koston e sherbimit. Njekohesisht ne sektorin e ujesjellesave do t'i hapet rruge terheqjes se kapitalit privat nepermjet kontratave koncensionare e te menaxhimit.

Energji e mjaftueshme, e lire dhe e garantuar

§ Zhvillimi ekonomik i vendit, shnderrimi i Shqiperise ne vendin me terheqes per investime te huaja ka nevojte per burime te mjaftueshme energjie me cmim sa me te lire, te garantuara dhe me akses te lehte per cdo biznes dhe per cdo familje. Mazhoranca e re dhe qveria e saj shpallin 4 vitet e ardhshme si vitet e luftes kunder erresires dhe pasigurise energjetike.

- Energjia elektrike do te jete nje fushe prioritare e qeverise e cila angazhohet se kjo energji nuk do t'i mungoje asnje familjeje dhe asnje biznesi kudo qofshin ato dhe pa diskriminim. Do te synohet qe brenda vitit 2007 te garantohet furnizimi i panderprere i energjise elektrike, objektiv ky qe do te sigurohet nepermjet kryerjes se reformave te thella dhe investimeve prioritare ne kete sektor. Ne periudhen ndermjetese do te eliminohen furnizimet diskriminuese rajonale te praktikuara ne keto vite e fundit nga KESH dhe qeverisja socialiste.
- Do te instalohen matesat ne te gjitha konsumatoret e per rrjedhoje do te marre fund brenda vitit 2006 faturimi aforfe. Ne kete kuader do te rishikohet dhe permiresohet edhe sistemi ekzistues i matjes. Nga ana tjeter do te ndeshkohen me rreptesi abuzimet dhe vjedhjet e energjise elektrike nga cdo perdorues i pandergjegjshem. Energjia elektrike do te paguhet e plote nga cdo konsumator. Per rrjedhoje do te mund te zvogelohen ne minimum humbjet joteknike qe sot perbejne rreth 800-1,000 milion kWh dhe do te rriten arketimet ne mbi 95% nga rreth 88% qe ishin ato ne vitin 2004.
- Qeveria do te vendose disiplinen financiare e administrative ne Korporaten Elektroenergjetike qe do te jape efekte pozitive ne rritjen e aftesive e saj per te prodhuar, importuar, transmetuar dhe shperndare me shume energji dhe me parametra me cilesore.

- Praktikak korruprive te importit te energjise do te marrin fund. Per kete do te rregullohet kuadri ligjor dhe praktikat per importin e energjise elektrike duke e bere ate transparent dhe te afte te siguroje energji te importuar ne sasi te mjaftueshme dhe me cmimin me te leverdisshem. Brenda mundesive teknike ne rritje KESH do te perdore metoden e depozitimit te perkohshem te energjise.
- Qeveria do te hape realisht tregun e energjise si dhe do te zbatoje ristrukturimin e privatizimin pjese-pjese te KESH brenda mandatit te saj 4-vjecar. Per kete qellim do te kryhet ndarja e veprimtarive si prodhimi, transmetimi, shperndarja dhe furnizimi i energjise elektrike ne kompani te vecanta sipas planit te veprimit te mbeshtetur nga Banka Boterore dhe BE. Enti rregullator do te mbeshtetet por edhe do te nxitet qe te rrise kapacitetet e tij rregullatore dhe te filloje te luaje rolin e arbitrit te paanshem ne kete treg te hapur. Shpejt do te nenshkruhet Traktati per Energjine i Komuniteti Energjetik te Europes Jug-Lindore te drejtuar nga BE dhe mbi kete baze do te plotesohet i gjithë kuadri ligjor ne menyre qe tregu i energjise te perafrohet me standartet dhe normat europiane dhe keshtu te integrohet ne tregun rajonal te energjise elektrike. Ne lidhje me privatizimin do te synohet privatizimi i te gjitha centraleve te vegjel dhe te mesem, veprimtarise se shperndarjes dhe ajo e furnizimit. Do te zgjerohen gjithashtu mundesite e konsumatoreve jofamiljare per te gjetur vete burimet e furnizimit me energji elektike nga furnizues te tjere te brendshem ose te jashtem. Hapja e tregut te energjise do te nxisë terheqjen e kapitaleve private dhe rritjen e ndjeshme te kapaciteteve prodhuese dhe furnizuese te sistemit elektroenergjetik shqiptar.
- Qeveria do te mbeshtese investimet ne prodhimin e energjise me termocentrale ne jug te vendit duke krijuar kushte per terheqjen e investimeve private, por vetem ne ato zona te vendit ku demi mjedisor eshte minimal dhe/ose kerkimit te zbatimit te standarteve me te larta te teknologjise dhe te ndotjes se ulet nga keto prodhues te energjise.
- Qeveria do te vazhdoje te mbeshtese integrimin e Shqiperise ne rrjetet e transmetimit rajonal dhe europian te energjise se te gjitha llojeve. Me prioritet do te konsiderohen ndertimi i linjave ndersisteme (interkoneksionit) si linja 400 kV Elbasan2-Tirana2-Podgorica si dhe nenstacionin e Tiranes 400/220/110 kV dhe linja 400 kV Tirana2-KosovaB, si dhe do te vazhdojne intensivisht studimet mbi mundesine e zgjerimit te interkoneksionit me Maqedonine dhe Italine. Qeveria do te beje perpjekjet maksimale per te siguruar anetaresimin e sistemit te transmetimit shqiptar ne Unionin per Kordinimin e Transmetimit te Energjise Elektrike (UCTE).
- Qeveria do te stimuloje menytrat alternative te prodhimit dhe perdorimit te burimeve te energjise dhe te konservimit te saj si pjese e politikës se saj energjetike por edhe mjedisore.
- Qeveria do te rivendose konkurrencen e lire ne tregun e karburanteve dhe do te eliminoje diskriminimin dhe tendencen monopol te ushqyer nga konflikti i interesave ne kete fushe si dhe do te aktivizoje instrumentat ligjore dhe institucionale per garantimin e cilesise se karburanteve qe do te sjelle pasoja

pozitive si per konsumatorët ashtu edhe per mjedisin.

Telekomunikacioni i lire, cilesor dhe i shumellojshem per te gjithë shqiptarët

§ Telekomunikacioni dhe teknologjia e informacionit konsiderohen si faktore thelbësore për një zhvillim të shpejtë e modern të vendit dhe integrimin e tij në Europë. Qeveria do të ndermarre reforma që hapin tregun e telekomunikacioneve dhe të teknologjisë së informacionit që sjell rritjen e investimeve private në këtë sektor, rritjen e aksesit në shërbime dhe rritjen e cilësive të këtyre shërbimeve. Për këtë qëllim qeveria,

- do të bëjë efektive krijimin e një tregu konkurrencial në fushën e komunikacioneve nëpërmjet iniciativave ligjore dhe institucionale, në rritjen e përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të entit rregullator pa cenuar autonominë e tij, hapjen e tregut për operatore të rinj të shërbimit celular dhe atij fikse, sigurimin e aksesit të barabartë të interkoneksionit për të gjithë operatorët në rrjetet e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg;
- do të nderprejë dhe ndëshkojë konfliktet e interesave në këtë sektor dhe favorizimet e abuzimet e kryera nga operatore që veprojnë në kushtet e konfliktit të interesave;
- nuk e njeh aktin e privatizimit të Albtelecom si një akt i kryer në kushtet e mungesës së plotë të transparencës mbi këtë proces. Qeveria do të angazhojë eksperte të pavarur ndërkombëtare për të vlerësuar këtë proces dhe marrjen e një vendimi përfundimtar bazuar në këtë vlerësim të paanshëm. Nderkohe, do të ndermerren masat e nevojshme për shëndoshjen financiare të kësaj korporate dhe shndërrimin e saj në një faktor zhvillues në tregun e hapur, duke vënë theksin në rritjen e ofertës së shërbimeve për operatorët e tjerë, përveç shërbimeve tradicionale ndaj klientëve.
- Si rezultat i hapjes së tregut dhe i forcimit të disiplinës së Albtelecom e privatizimit të tij, shkalla e penetrimit për familje të telefonisë fikse do të arrijë në 90% duke u trefishuar në krahasim me nivelin e sotëm.
- Qeveria do të hapë tregun për operatorët që ofrojnë shërbimet e teknologjisë së informacionit duke e bërë shtetin një konsumator kryesor të kësaj shërbimi, gjë e cila do t'i japë një impuls shtesë kësaj sektori derisa të mund të zgjerohet konsumi privat i tij. Në vecanti investimi në teknologjinë e informacionit në administratën publike "Qeverisja Elektronike", si dhe në sektorin e arsimit do të përbejnë pjesë të rëndësishme të kërkesës në këtë fazë të zhvillimit të tregut të kësaj teknologjie.

ZHVILLIMI NJERËZOR

xx) Zhvillimi njerezor eshte synimi me madhor i shoqerise shqiptare dhe investimi per te do te perbeje prioritetin kryesor te projektit te ndryshimit te mazhorances se re dhe qeverise se saj. Qeveria konsideron rritjen e aksesit ne nje arsim cilesor e masiv te shqiptareve si politiken e pare ne kete drejtim. Permiresimi i treguesve te shendetit publik eshte gjithashtu jetik ne rritjen e nivelit te burimit njerezor. Realizimi i cdo individi permes kultures dhe sportit do te jete ne vemendje te politikave qeveritare. Reformat dhe programet qeveritare ne kete fushe do te hartohen dhe zbatohen nepermjet konsultimit e pjesemarrjes se grupeve te interesit ne nivel rajonal e kombetar te organizuar deri ne nivelin e nje Keshilli Kombetar per Zhvillimin Njerezor.

Arsim cilesor dhe masiv

§ Edukimi i shqiptareve eshte procesi me i rendesishem si qytetare te denje dhe individe te sukseshem. Edukimi ne Shqiperi dhe, vecanerisht sistemi arsimor, ka pesuar renie dramatike ne treguesit e vet sasiore dhe cilesore. Aksesit ne arsimin baze dhe vecanerisht ate te mesem eshte ulur shume, kryesisht ne zonat rurale te vendit ku edhe kushtet dhe cilesia e arsimit jane teper preokupuese. Nderkaq, ne qendrat urbane te vendit ndeshet nje mbipopullim i larte i shkollave qe demton rende mesimdhenien. Arsimtaret mbeten kategoria me e keqpaguar e punonjesve buxhetore. Shpenzimet publike per arsimin kane rrene nga 4.2 % ne vitin 1996, ne 2,8 % te PBB-se. Mesatarja e viteve te arsimit ka rrene nga 11,5 ne 9.2 vite ne vitin 2004 nga 15.4 qe eshte ky tregues per vendet e OECD-se. U mbyllen rreth 85 % e shkollave te mesme ne zonat rurale, si dhe numri i shkollave profesionale u zvogelua 6 here. Arsimi universitar publik ndodhet ne kushtet e nje autonomie difektoze, jo rralle te kercenuar, me mjete te pakta dhe me cilesi produktesh qe nuk po i pershtaten kerkesave te kohes e te tregut.

§ Kjo gjendje e rende e arsimit kerkon nje nderhyrje energjike dhe vizionare. Vizioni i qeverise per arsimin bazohet ne modelin e edukimit te vazhdueshem duke filluar qe ne moshen parashkollore dhe qe vazhdon gjithe jeten. Qellimi i sistemit arsimor do te jete formimi i aftesive individuale per te perfitur dije per ta perdoruar ate. Sistemi arsimor do te bazohet ne autonome shkollore.

§ Per te arritur keto qellime qe do te mundesojne arritjen e nje niveli europian arsimimi si kusht i domosdoshem per zhvillimin europian te vendit, qeveria angazhohet per nje reforme teresore ne arsim te mbeshtetur nga burime te konsiderueshme publike, nga zgjerimi i mbeshtetjes se partnereve nderkombetare si dhe perfshirja e sektorit privat ne kete fushe. Reformat arsimore do te hartohen dhe zbatohen ne konsultim e bashkepunim te gjere me grupet e interesit.

- Do te kryhet reforma e plote e curriculave mesimore me qellim qe ato t'i pershtaten nevojave te nxenesve dhe shoqerise ne kete shekull. Kjo do te arrihet permes konsultimit te ekspertizes me te mire, perfshire grupet e interesit ne hartim e tyre si dhe liberalizimit.
- Do te vendose statusin e mesuesit si pike reference per shoqerine dhe komunitetin me gjithe respektin qe ai meriton. Qeveria do te rrise 50% pagen e arsimtareve brenda vitit te dyte te mandatit dhe do ta dyfishoje ate deri ne fund te

ketij mandati. Pagat me te mira do te shoqerohen me mekanizma qe sigurojne rritjen e profesionalizmit dhe te perkushtimit ne mesimdhenie. Incentiva te vecanta do te perdoren per mesuesit ne zonat e largeta e te veshtira.

- Do te mundesoje nje permiresim rrenjesor te kushteve te shkollimit permes ndertimit e riparimit te godinave shkollore dhe pajisjes me mjete didaktike moderne. Do te synohet ulja e numrit mesatar te nxenesve per klase ne nivelin e 25-30 nxenes.
- Do te sigurohet kompjuterizimi dhe lidhja ne internet ne cdo shkolle e klase si dhe mesimi masiv i gjuhes angleze.
- Ne arsimin parauniversitar do t'i jepet nje perparesi shkollave te mesme profesionale ne perputhje me tendencat rajonale te zhvillimit ekonomik e te tregut te punes. Ne zonat rurale do te hapen nje numer i madh shkollash profesionale kryesisht te profilit te agrobiznesit. Ne shkollat profesionale do te synohet te terhiqet me shume se 40% nxenesve te shkollave te mesme.
- Reforma institucionale ne arsim bazuar ne autonome shkollore do te percaktoje rolin e personelit shkollor komunitetit prinder/nxenes dhe pushtetit vendor. Performanca e sistemit arsimor, ne teresi, ne nivel shkolle e ne nivele te tjera do te monitorohet dhe vleresohet permes instrumentave adekuate dhe me transparence.
- Synohet qe shpenzimet publike per edukimin, perfshi ate universitar, te perbejne zerin e pare ne buxhetin e shtetit duke arritur ne nje nivel prej 5% te PBB-se. Shperndarja e fondeve do te orientohet per nga numri i nxenesve. Krahas fondeve publike, ne permbushjen e objektive te arsimit parauniversitar do te kontribojne edhe iniciativa private.
- Synohet qe ne fund te periudhes 4-vjecare te arrihet niveli prej 100% te kryerjes se arsimit 9 vjecar dhe niveli 88% i kryerjes se arsimit te mesem te pergjithshem ose profesional. Terheqja e femijeve ne sistemin e edukimin parashkollor synohet te arrije ne rreth 60%.
- Arsimi universitar do te synoje formimin e te diplomuarve me njohuri shkencore e profesionale te cilesise se larte per te qene te afte te konkurrojne ne nje ekonomi ne hapje dhe zhvillim si dhe ne perputhje me proceset integruese e globalizuese. Qeveria gjithashtu synon masivizimin e dijes universitare duke mbeshtetur e nxitur shkollat e larta publike qe te hapin dyert per te rinjte shqiptare. Rritja cilesore dhe masivizimi universitar do te mbeshtetet edhe nga iniciativa private ne kete fushe.
- Do te permiresohet dhe plotesohet autonomia e universiteteve publike vecanerisht ne aspektet administrative, financiare e pronesore. Kjo autonomi do te bashkeshoqerohet me permiresimin e mekanizmave te 'check and balance' dhe me tendencen e rritjes se eficiences financiare.
- Qeveria do te intensifikoje reformimin universitar ne perputhje me parimet dhe

objektivat e procesit te Bolonjes ne drejtim te strukturese se studimeve (3+2 vite), ngritjes se sistemit te vleresimit te cilesise permes akreditimit, adoptimit te sistemit te krediteve, unifikimit te procedurave te njohjes se diplomave sipas normave te BE-se.

- Qeveria konsideron se universitetet publike mund te ecin shume drejt vetefinancimit permes tarifave te shkollimit dhe te ardhurave nga sherbime te tjera. Nga ana tjetere, qeveria do te mbeshtese studentet nga familjet e vobeketa ndersa studentet e shkelqyer edhe duke u krijuar mundesira qe ata te plotesojne shkollimin ne universitetet perendimore.
- Qeveria angazhohet per nje politike aktive te thithjes se trurit nepermjet programeve te 1000 shkencetareve te rinj, krijimit te grupeve te ekselences dhe forma te tjera qe do te rekuperojne largimin e trurit qe ka ndodhur ne menyre dramatike ne keto vite te tranzicionit.
- Qeveria i konsideron universitetet e Shkodres, Elbasanit, Vlores, Gjirokastrës e Korces jo vetem si shkolla te larta por edhe si qendra qe mund te kontribuojne per zhvillimin e ketyre rajoneve dhe per kete qellim do te mbeshtese me fonde dhe porosira shtetere keto universitete per te luajtur kete rol. Do te hapet Universiteti i Durresit dhe do te studiohet mundesia e hapjes se universiteteve publike ne rrethe te tjera, por pa demtuar procesin e rritjes cilesore e sasore te universiteteve aktuale.
- Qeveria do te studioje mundesine qe institute ne kuader te Akademise se Shkencave, dhe institute te tjera, te cilet mbuloje shkenca te sakta ose natyrore te gjejne forma bashkepunimi e integrimi me universitetin perkates.

Sherbim shendetesor i garantuar, cilesor dhe i ndershem

§ Sistemi shendetesor gjate ketyre viteve, per shkak te ngadalesimit dhe bllokimit te reformimit te tij ne nje sistem shendetesor bashkekohor, eshte ne degradim. Shume prej treguesve te shendetit te popullsisë po pesojne perkeqesim te dukshem. Nga njera ane sistemi i amortizuar, me performance te ulet e nga ana tjetere ulja e nivelit te jeteses e ndikimi i nje mjedisi te tejndotur, perbejne nje kercenim serioz per shendetin e te gjithëve e ne vecanti per femijet e te moshuarit.

§ Qeveria angazhohet per nje reforme teresore te sistemit shendetesor ne te gjitha nivelet e tij duke e shoqeruar ate me alokim te konsiderueshem fondesh per investime publike.

- Reforma ne sektorin e kujdesit paresor do te kombinoje decentralizimin me investime te konsiderueshme per mjetet, godinat dhe burimet njerezore nga fondet publike dhe ato te partnereve nderkombetare dhe me zgjerimin e skemes se sigurimit te kujdesit shendetesor ne kete sektor. Efektet e reformes do te ndjehen ne rritjen e cilesise se sherbimit, mbulimin e mbare vendit me sherbim shendetesor, afrimin e sherbimit sa me prane qytetarit. Vemendje e vecante do t'i kushtohet kujdesit per nenen dhe femijen.

- Sistemi spitalor, aktualisht i amortizuar, do te zhvillohet nepermjet rajonalizimit dhe perqendrimit duke synuar rritjen e performances se tij. Kjo reforme do te kombinohet nga nje ane me rritjen e disiplines dhe nga ana tjeter me pergatitjen e me pas futjen e plote te spitaleve ne skemen e sigurimeve shendetesore. Edhe ne kete sektor do te alokohen fonde te shumta publike e te partnereve nderkombetare.
- Qeveria e mazhorances se re do t'i shpalle lufte frontale korrupsionit ne shendetesi dhe do te garantoje disiplinen mjeksore te sherbimit dhe disiplinen financiare e administrative te tij por nga ana tjeter do te rriten me 30-40% pagat e mjerueshme te ketij sektori deri ne fund te vitit te pare te qeverisjes. Rendesi e vecante do t'i jepet trainimit te vazhdueshem dhe riciklimit te personelit shendetesor.
- Sektori i shendetit publik do te reformohet dhe modernizohet. Institucionet e ketij rrjeti do te mbeshteten ne programet e tyre te parandalimit te semundjeve, ne vecanti kryerja e plote e vaksinimeve masive, e te promocionit shendetesor, te kontrollit te ujit te pijshem, te ajrit etj. Gjithashtu ne kete sektor do te rritet roli i pushtetit vendor. Ky sektor, ne bashkepunim me ate te kujdesit paresor dhe ate spitalor do te hartoje e do te zbatoje projekte kombetare per semundje te tilla si tumoret, semundjet e zemres, AIDS, traumat etj
- Do te nxitet zhvillimi i sektorit privat ne shendetesi si ne sherbimin paresor, spitalor si dhe ne sherbimet ndihmese. Por njekohesisht do te kihet kujdes per evitimin e konfliktit te interesave qe mund te linde.
- Sistemi i sigurimeve shendetesore do te reformohet me synim nga nje ane rritjen e shkalles se vjeljes se kontributeve dhe nga ana tjeter fuqizimin institucional te ISKSH. Do te nxitet gjithashtu edhe krijimi i ofertes private te sigurimeve vullnetare.
- Qeveria do te marre masat kunder tendences monopol dhe konfliktit te interesave ne tregun farmaceutik. Gjithashtu do te forcohet kontrolli dhe garantimi i cilesise se barnave me synimin qe tregu shqiptar te furnizohet me barna te standarteve europiane.
- Grupe te vecanta shoqerore do te gezojne sherbime te vecanta dhe/ose lehtesira tarifore per sherbim mjekesor dhe perdorim te barnave. Me perparesi do te konsiderohen nena dhe femija, individet me aftesi te kufizuar, pensionistet etj.

Kultura dhe sporti ne sherbim te zhvillimit ekonomik e njerezor

§ Mbrojtja, forcimi dhe shpalesja e identitetit kombetar perkundrejt sfidave te tregut dhe ne vecanti te ekspansionit globalist do te jete parimi baze i politikave kulturore te Qeverise.

- Objektivi i qeverise eshte shnderrimi i politikave te kultures nga instrument i

"estetizimit" te qeverisjes, ne nje ushqim te vertete shpirteror, te cideologjizuar per cdo shqiptar, ne Shqiperi, ne Ballkan e kudo qe jeton.

- Qeveria do te synoje shumfishimin e buxhetit per kulturen, por njekohesisht edhe ngritjen e fondeve nga donatoret, organizatat nderkombetare, si dhe nga burimet e brendshme private per te siguruar konservimin e zhvillimin e trashegimise sone kombetare, mbeshtetjen, promovimin dhe njeheresh dhe mbrojtjen e arteve, krijuesve dhe vepres se tyre dhe garantimin e pronesisë intelektuale.
- Ne vemendje te Qeverise, ne beshkepunim me qeverite vendore, shoqerine civile e komunitetin e biznesit do te jete dinamizimi dhe shperndarja me e mire e aktiviteteve kulturore ne periferi dhe me ne vecanti atyre ne zonat turistike, nepermjet krijimit te programeve te Art-Turizmit, te cilat do t'i sherbejne pasurimit te jetes se qytetareve, por edhe promovimit te identitetit tone si popull ne arenen e sotme te globalizmit.
- I gjithe kapitali historik, etnografik, kulturor e artistik do te vihet ne sherbim, me mjetet dhe forma te pershtatshme ne sherbim te zhvillimit ekonomik te vendit e ne vecanti te zhvillimit te turizimit.
- Qeveria do te ndermarre nismat e nevojshme per ristrukturimin e rrjetit te institucioneve kulturore duke synuar pavaresimin e tyre dhe sigurimin mjeteve te nevojshme financiare per shtimin sasior dhe rritjen cilesore te aktivitetit kulturor e artistik.

§ Rritja e vemendjes dhe e shpenzimeve mbeshtetese te qeverise ndaj zhvillimit dhe perhapjes se sportit do te behet me qellim qe sporti te sherbeje qofte si nje mjet per zhvillimin njerezor e shpirteror te cdo individi e vecanerisht te femijeve e te rinjve, ashtu edhe si zbavitje dhe mundesi e shpalosjes se vlerave kombetare ne kete sferë kompetitive qe bashkon njerezimin.

- Perhapja masive e kultures sportive do te perbeje nje nga prioritetet e politikave qeveritare ne kete fushe. Objektivat do te arrihen nepermjet mjeteve dhe instrumentave qe rrisin rolin e shkolles, shoqerise civile, biznesit dhe qeverisjes vendore ne shtimin e kapaciteteve teknike e teknologjike sportive dhe perhapin edukimin sportiv
- Qeveria do te mbeshtese strukturat autonome organizative te sportit kombetar me mjete si dhe do te permiresoje kuadrin ligjor e institucional qe sporti kombetar te gjeje me shume mbeshtetje edhe nga sektori privat. Krahas kesaj qeveria do te marre masa edhe per te luftuar instrumentalizimin dhe korruptimin e ketyre strukturave

PRIORITETET E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE POLITIKAT MBESHTETESE

xxi) Ekonomia shqiptare bazuar ne modelin e tregut eshte nje ekonomi e re e ne hapat e para te shfaqes se tipareve dhe shanseve te saj kompetitive si pjese e ekonomise rajonale, europiane e boterore qe tenton drejt integritimit dhe globalizimit. Gjithsesi, ne projektin e saj te ndryshimit, Qeveria vlereson se fushat prioritare qe do te mundesojne nje zhvillim te shpejte e te qendrueshem ekonomik te vendit per te paktet 10-15 vitet e ardheshme jane turizmi, bujqesia/agroindustria dhe eksportet. Te tre keto fusha vleresohen se jane te lidhurar ne nje kluster te agreguar qe duke u zhvilluar sebashku do te mundesojne rritjen e kompetitivitetit ne teresi te ekonomise shqiptare nepermjet kombinimit te iniciatives, energjise krijuese, kapitaleve dhe traditen e shqiptareve me investimet dhe know-how e huaj. Zhvillimet ne keto fusha do te mbeshteten nga programi teresor i qeverise por atyre do t'u kushtohen edhe programe specifike. Disa nga programet kryesore specifike per keto fusha jane:

Turizimi dhe rritja e e tij e shpejte, cilesore dhe shumeformeshe

§ Zhvillimi i turizmit te qendrueshem dhe harmonik, duke ruajtur dhe zhvilluar trashegimine kulturore dhe natyrore eshte objektiv paresor i Qeverise. Natyra, ekologjia dhe traditat e vendit, kultura, folklori, pasurite e shumta arkeologjike te te gjitha periudhave, qytetet muze dhe monumentet historike ofrojne mundesite per zhvillimin e te gjitha llojeve te turizmit, duke i dhene atij natyre dhe karakteristika krejtesisht shqiptare. Potencialet turistike te vendit jane nen nje kercenim serioz si pasoje e politikave inefektive dhe korruptive te qeverive socialiste. Tolerimi i abuzimeve ne zonat turistike, grabitja e trojeve nga klane te lidhura me pushtetin, ndotja e larte e ujrave bregdetare, tokes, demtimi i ekosistemeve, infrastruktura dhe sherbimet e pamjaftueshme deri te munguara jane problemet dhe reziqet per turizmin. Bllokimi i kesaj gjendjeje dhe rikthimi i zhvillimit te turizmit sipas nje modeli te qendrueshem eshte nje ceshtje jetike per te sotmen dhe te ardhmen. Zhvillimi i turizmit do te mbeshtetet ne plane rregulluese e programe qe stimulojne aktivitetin privat shqiptar e te huaj e qe njekohesisht mbrojne mjedisin dhe perspektiven e sektorit.

- Zhvillimi i infrastruktures, vecanerisht asaj rrugore, furnizimi me uje dhe trajtimi i ujrave te zeza me perparesi ne zonat turistike bregdetare si dhe garantimi i furnizimit me energji elektrike do te perbejne nje mbeshteje te rendesishme per zhvillimin e turizmit.
- Qe ne vitin e pare te qeverisjes do te merren masa te forta ligjore per te bllokuar cdo tentative per zhvillime kaotike e kercenuese per zhvillimin e turizmit. Gjithashtu te zbatohen denime dhe prishje ne ato raste kur kjo behet e domosdoshme.
- Ne funksion te zhvillimit turistik me prioritet do te konsiderohen rruget Durres-Morine, Lushnje-Vlore; ristrukturimi zgjerues i rruges se Bregut, ndertimi i nje aeroporti ne Jug te vendit dhe vepra te tjera infrastrukture.
- Mazhoranca e re ka shfaqur kundersiztimin e saj per ndertimin e termocentralit prane Vlores pa marre me pare mendimin e komunitetit vlonjat. Kryerja e referendumit per kete ceshtje do te gezoje mbeshtetjen e qeverise. Gjithsesi,

qeveria do te angazhohet qe te zgjidhe ceshtjet e sigurimit me energji te mjaftueshme te zonave turistike te vendit, sidomos ne jug te vendit dhe do te studioje zgjidhjet me te pershtatshme qe pajtojne zhvillimin energjetik me ate turistik e mjedisor.

- Qeveria ne bashkepunim me sektorin privat do te zhvilloje nje fushate te gjere dhe nderkombetare te marketingut per sektorin si dhe ngritjen e nje rrjeti zyresh perfaqesimi. Per kete qellim do te dyfishohen fondet per marketingun e turizimit. Fushata do te synoje edhe turistet nga vendet europiane dhe aziatike nepermjet marketingut ne media prestigjioze. Qeveria do te mbeshtetse promocionin turistik dhe fuqizimin e rrjetit te privat te operatoreve turistike e te komunikimit te tij me te gjitha njesite pritesese dhe ofruese te sherbimeve turistike te te gjitha llojeve e te sherbimeve te tjera te lidhura me turizmin duke vene ne qender te kesaj qasjeje turistin dhe preferencat e tij.
- Programet mbeshtetese per sektorin do te kombinojne lehtesirat fiskale me ato proceduriale si dhe do te nxisin format e gershetuara te turizmit qe ofrojne sherbime te shumellojshme dhe levizje te turisteve ne pjese sa me te gjera te territorit te vendit duke shfrytezuar jo vetem potencialet e turizimit bregdetar por edhe te atij kulturor, historik e etnografik, te turizmit malor mjedisor e te agroturizmit.
- Qeveria do hape te gjitha mundesirat qe biznesit privat t'i jepet prioritet per te kontribuar ne zhvillimin jo vetem te vete turizmit por edhe ne infrastrukturen qe lidhet me zhvillimin e turizmit.
- Per pasoje do te arrihet qe ne fund te periudhes 4 vjecare numri i turisteve te kaloje mbi 500 mije ne vit dhe te ardhurat nga turizmi te kalojne shifren prej 800 milion euro ne vit.

Kalimi nga aktiviteti bujqesor ne biznesin agrar. Zhvillimi i agroindustrise.

§ Me gjithë potencialet e konsiderueshme dhe traditen e shendoshe te fermereve shqiptare, gjendja e bujqesise shqiptare eshte ne nivele te mjeruara.

§ Ne vitet e qeverisjes socialiste nuk u arrit perfundimi i procesit te garantimit te te drejtave te pronesise mbi token dhe regjistrimi i tyre. Tregu i tokes mbeti i mbyllur. Konkurrenca e pandershme e monopoleve qeveritare frenoi komercializimin e produktit vendas. Mungesa e infrastruktures dhe abuzimi me fondet buxhetore kane shkatuar nje renie te shkalles se ujitjes dhe rritjen e erozionit te tokes.

§ Zhvillimi i bujqesise sebashku me agroindustrine do te mbeshtetet ne disa politika dhe reforma baze dhe nxitese per sektorin. Investimet publike dhe te partnereve nderkombetare ne bujqesi do te rriten ndjeshem por edhe do te perdoren me efektivitet dhe eficience.

- Mazhoranca e re dhe Qeveria e saj i garanton fermeret shqiptare se do te zgjidhe perfundimisht ceshtjen e pronesise mbi token duke garantuar te drejtat e

fituara me ligjin Nr. 7501. Fermeret shqiptare, brenda nje viti do te gezojne plotesisht te drejtat e pronesise nepermjet ri-aktivizimit me ritme te larta te projektit te regjistrimit te tokes. Tregu i hapur i tokes do te nxise procesin e rritjes se dimensionit te fermave.

- Investimet ne infrastrukture agrare si dhe ne ate te menaxhimit e mbrojtjes se tokes, krahas asaj rrugore rurale, do te marrin nje perparesi te vecante
- Do te zgjerohet dhe permiresohet sherbimi i keshillimit dhe mbeshtetjes se iniciativave kooperuese te fermerëve. Do te behet ristrukturimi i plote i sherbimit veterinar e profilaktik dhe do te jepen keto sherbime falas. Do te sigurohet furnizimi me cmime te subvencionuara te imputeve si dhe do te fuqizohet kontrolli i cilesise se tyre.
- Karburanti per konsum bujqesor do te sigurohet me nje cmim prej jo me shume se 40 lek per liter, per te gjithë fermeret shqiptare.
- Do te shumefishohet aksesin ne sistemin e kredise nepermjet zgjerimit te skemave te mikrokredise e deri tek banka e zhvillimit agrar e rural sipas modelit reciprok, si dhe do te rritet mbeshtetja me teknologji, mekanike e inputet baze bujqesore.
- Do te rihapen nje rrjet i tere shkollash te profilit agrar e agroperpunues sipas modelit amerikan.
- Shanset me te mira per bujqesine shqiptare jane frutikultura, perimtaria, vreshtaria dhe blegtoaria te cilat do te kene nje trajtim prioritar nga politikat e zhvillimit agrar te qeverise vecanerisht ne drejtim te rritjes se prodhimit ne sera, ndersa bimet e arave, aty ku ka interes dhe mundesi, do te mbeshteten duke perdorur edhe cmimet nderkombetare te grumbullimit nga ana e shtetit. Ulliri do te jete nje kulture qe do te gezoje nje mbeshtetje te vecante nga shteti pasi potencialet e Shqiperise ne kete kulture jane mjaft te medha.
- Programet ne kete sektor do te mbeshtetin rritjen e shpejte dhe te diversifikuar te industrise agroperpunuese te vogel, te mesme e te madhe nepermjet se ciles do te rriten shanset si te uljes se importeve ushqimore eshtu edhe te rritjes se eksporteve te ketyre produkteve krahas eksporteve te produkteve te fresketa. Nje nga masat me te shpejta qe do te ndermerren do te jete hapja e tregut ne kete sektor i cili sot eshte nen kontrollin e grupeve te medha te lidhura me qarqet ish-qeveritare.
- Ne sektorin e agrobiznesit do te aplikohen politika lehtesuese fiskale si: perjashtimi 3 vjecar nga tatimet per biznese e reja agrare dhe agroindustriale; ulje me 20% me pak te tatimit mbi fitimin per per bizneset te orientuara ne eksportin e produkteve ushqimore e te mallrave te tjera bujqesore e blegtorale.
- Zhvillimet ne sektorin e bujqesise dhe agroindustrise do te mbeshteten edhe

nga ngritja e fuqizimi i sistemit te kontrollit, certifikimit e standartizimit te produkteve bujqesore e agroushqimore si per te garantuar konsumatorin vendas ashtu edhe per te arritur standartet europiane ne sherbim te rritjes se eksporteve.

- Zhvillimi i bujqesise dhe i agroindustrise do te kombinohet me programin e zhvillimit te integruar rural.
- Hapja tregtare e vendit do te vazhdoje sipas angazhimeve te ndermarra nga shteti shqiptar ne kuadrin e OBT-se dhe te marreveshjeve te tregtise se lire, duke e konsideruar hapjen si nje mundesi per me shume eksporte por duke rishikuar regjimin e hapjes per produkte te vecanta mbeshtetur ne mekanizmat ri-negociues qe vete keto marreveshje ofrojne.

Rritja e konkurrueshmerise dhe kapja e tregjeve per eksport.

§ Eksportet do te jene matesi i zhvillimit te ekonomise shqiptare. Potencialet eksportuese shqiptare do te rriten si per shkak te rritjes se iniciatives shqiptare ne kete fushe te te gjitha dimensioneve ashtu edhe nxitjes se investimeve te huaja direkte nepermjet permiresimit te klimes dhe mjedisit mbeshtetes per to. Per kete qellim, ne projektin e saj te ndryshimit, Qeveria do te krijojte nje mjedis proeksport, nepermjet:

- Zhvillimit te infrastruktures institucionale mbeshtetese per eksportet, fuqizimin e institucioneve te certifikimit, kontrollit te cilesise dhe standarteve se bashku me nxitjen e pjesemarrjes se firmave shqiptare ne programet europiane te cilesise.
- Rrjeti diplomatik dhe i atesheve tregtare, ne bashkepunim me komunitetin e biznesit do te vihet ne sherbim te eksportuesve shqiptare dhe te thithjes se investimeve te huaja.
- Rimbursimin e menjehershem te TVSH-se per firmat e eksportit dhe lehtesim me 20% te tatimit mbi fitimin per firmat qe punojne per eksport.
- Mbeshtetjen dhe bashkepunimin me partneret nderkombetare dhe sektorin privat si dhe me institucionet kerkimore dhe universitare per mbeshtetjen e sektorit me know-how dhe informacion.
- Nxitja e investimeve te huaja me qellim eksporti. Rendesia e ketyre investimeve eshe me e madhe ne lidhje me eksportet duke konsideruar know-how qe posedojne investitoret e huaj, lidhjet me te mira me tregjet dhe njohjen e standarteve e procedurave te vendeve te tyre. Edhe per kete shkak, rritja e investimeve te huaja direkte do te perbeje nje prioritet te vecante te qeverisjes demokratike.
- Krijimi i lehtesirave nepermjet parqeve industriale dhe lehtesirave te tjera proceduriale e doganore, si zgjerim i praktikave duty free per eksportet, linja kreditimi te favorshme per eksportet e siguruara, sherbime te pershtatshme dhe

stimuj te tjere mikroekonomike per eksportuesit shqiptare dhe te huaj.

- Vazhdimin e politikës së hapjes tregtare dhe lidhjen dhe/ose rishikimin e marrëveshjeve sa më të pershtatshme tregtare me rajonin, BE-në dhe zonë të tjera me interes tregtar dhe potencial eksportues në kuadrin e OBT-së

ZHVILLIM I INTEGRUAR E HARMONIK URBAN, RURAL DHE MBROJTA E MJEDISIT

xxii) Zhvillimi i shpejtë por i qëndrueshëm është një synim themelor dhe përbën modelin e zhvillimit të projektit të ndryshimit të mazhorancës së re dhe qeverisë së saj. Qëndrueshmëria e zhvillimit shqiptar është vënë në pikepyetje gjatë 8 viteve të qeverisjes socialiste. Rrenimi dhe varferia rurale, "ruralizimi" i zonave urbane e turistike, degradimi i mjedisit dhe demtimi i potencialeve të burimeve natyrore janë tiparet e zhvillimit të kësaj qeverisjeje. Rikthimi i vendit në rrugën e zhvillimit të shpejtë por të balancuar e të qëndrueshëm në të gjithë hapësirën është një domosdoshmëri jetike për vendin. Një zhvillim i tillë do të bazohet në një vizion dhe qasje që siguron një zhvillim integral të hapësirës urbane dhe rurale si dhe një mbrojtje të mjedisit. Vizioni i Qeverisë do të arrihet nëpërmjet kombinimit efektiv të politikave sektoriale nën një qasje të integruar që mundëson:

Zhvillimi i integruar rural përfshirë zonat malore të vendit

§ Një zhvillim i integruar rural i cili nuk bazohet vetëm në zhvillimin bujqësor por në një zhvillim të diversifikuar ku ekonomia jo-bujqësore do të rritet gradualisht peshën e saj të punëzimit dhe të prodhimit në zonat rurale është vizioni i mazhorancës së re dhe qeverisë së saj.

- Zhvillimi i infrastrukurës dhe i shërbimeve publike e private, veçanërisht zhvillimet sasiore e cilësore në energji, furnizim me ujë, shfrytëzimi i harmonizuar i territorit dhe tokës dhe i organizimi urban i fshatrave, zhvillimi i arsimit e shëndetësisë në këto zonë do të ndryshojnë cilësisht jetesën rurale.
- Mbrojtja e mjedisit dhe e tokës, rritja e aksesit dhe shkallës së përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore nga komunitetet dhe individët në këto zonë do të përbejë një tjetër drejtim të mbështetjes së një zhvillimi të integruar të zonave rurale e malore të vendit.
- Reforma e decentralizimit, mbështetja e bashkëpunimit ndërkomunor, reformat territorialo-administrative me vizion rajonal do të jenë faktorët institucionale në mbështetje të këtij zhvillimi të integruar ndërsa komunitetet e zonave rurale të organizuara sipas interesave dhe fushave janë faktori njerezor dhe kapitali social për arritjen e këtij zhvillimi.
- Qeveria do të jetë partneri dhe mbështetësi i këtyre aktoreve. Për këtë qëllim

do te reformohen dhe fuqizohen instrumentat e qeverise si Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjensia e Zhvillimit te Zonave Malore, fondacionet e mikrokredise, rrjetet e tjera te institucioneve publike te mbeshtetjes se zhvillimit rural e malor me pjesemarrje te qeverise duke iu pershtatur konceptit te zhvillimit te integruar rural vendor e rajonal.

Zhvillimi harmonik e i qendrueshem urban. Legalizimi i banesave.

§ Zhvillimi urban do te mbeshtetet ne qasjen e zhvillimit harmonik e te qendrueshem kombinuar me perdorimin racional te territorit urban, zhvillimin e teknologjise urbane dhe forcimin e kultures urbane te jeteses.

- Qytetet e Shqiperise do te zhvillohen bazuar ne studime afatgjata e plane urbanistike vizionare qe i paraprijne zgjerimit urban, qe respektojne tendencat e natyrshme por edhe i orientojne ato. Kaosit urban do t'i jepet fund menjehere. Do te hapet tregu i ndertimeve dhe do te marrin fund praktikat korruptive, diskriminuese e klienteliste ne dhenien e lejeve te ndertimit por nga ana tjetere do te synohet te ruhen dhe shtohen hapesirat publike me prioritet ato te gjelberta dhe do te adoptohen masa te forta ndeshkuese ndaj abuzuesve dhe zaptuesve te ketyre hapesirave.
- Ne vecanti ne zonat urbane me ardhje popullsie nga zona te tjera te vendit do te mbyllet brenda vitit te pare te qeverisjes procesi i legalizimeve te banesave. Qytetaret do te paguajne 100-400 mije leke per legalizimin dhe fitimin e pronesise mbi token. Procesi i legalizimeve do te pershkohet nga elemente sociale ne favor te shtresave ne nevojte. Nderkaq, shteti merr persiper kompensimin e pronareve per token e zene nga te gjithet te shperngulurit ne te gjithet vendin. Legalizimi i shtesave te pallateve do te behet me nje gjobe prej 4% te cmimit te tyre. Keto zona do te futen ne programe te vecanta urbanizmi nepermjet investimeve te fuqishme ne infrastrukture dhe ne sherbimet baze publike te arsimit dhe te kujdesit shendetesor paresor. Por procesi i legalizimit nuk do te beje tolerim ndaj abuzimit dhe do te diferencojte ndertimet per nevojat sociale nga abuzimet per qellime perfitimi.
- Sistemi rrugor perfshire sinjalistiken dhe parkimin, i furnizimit me uje dhe i kanalizimeve, sherbimet e pastrimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane, ndricimi publik, telekomunikacioni dhe informimi do te mbeshteten me prioritet nga qeveria.
- Mjedisi nxites per iniciativen private do te ofroje mundesi punesimi dhe fitimi, sherbime te shumellojshme dhe mundesi argetimi per te gjithet moshat e popullsise urbane. Keto permiresime sebashku me disiplinën urbane dhe shtimin e siperfaqeve te gjelberuara do te sjellin nje permiresim cilesor te ajrit ne qytetet e vendit e per pasoje edhe te treguesve te shendetit te popullsise urbane.
- Komunitetet urbane jane nje potencial emancipimi dhe zhvillimi kulturor e shpirteror, nje mundesi qytetarizimi dhe europianizimi e per kete qellim qeveria do te mbeshtete nje gjallerim dhe pasurim e jetes urbane si dhe do te nxise iniciativat e pushtetit vendor, shoqerise civile dhe te komunitetit te biznesit ne kete fushe.

- Zhvillimi urban do te konsideroje me perparesi ruajtjen e tipareve urbanistike dhe te trashegimise urbane, kulturore, etnografike e komunitare te qyteteve te Shqiperise ne radhe te pare, Gjirokastra, Shkodra, Berati, Korca, Elbasani, duke i konsideruar ato si nje kapital i fuqishem per zhvillimin jo vetem te ketyre zonave urbane por si pole zhvillimi per rajonet dhe per vendin ne teresi, vecanerisht te lidhur me zhvillimin e turizimit.
- Qeveria do t'i shpalle lufte te pameshirshme shperndaresve te droges dhe kriminimit me synimin e garantimit te jetes, shendetit dhe prones se qytetareve. Forcat e rendit do te riorganizohen per te siguruar rendin dhe qetesine edhe ne pjeset me kriminalitet me te larte ne zonat urbane.
- Zhvillimi i integruar urban do te realizohet ne radhe te pare nga vete bashkete qe do te operojne ne nje autonomi te zgjeruar nepermjet zbatimit me shpejtesi dhe vendosmeri te reformes se decentralizimit. Ai do te realizohet gjithashtu nga komunitetet e ketyre zonave te cilat do te mbeshteten gjithnje e me shume ne iniciativat e tyre komunitare ne shkalle te vogel apo te madhe. Shoqeria civile, komuniteti i biznesit dhe elitat e qyteteve jane aktoret baze qe do te realizojne kete zhvillim. Qeveria do te jete mbeshtetese dhe partnere e tyre ne kete zhvillim te integruar.

Mbrojtja e mjedisit dhe perdorimi i qendrueshem i burimeve natyrore

§ Degradimi i mjedisit, humbja e vlerave te medha natyrore, niveli i larte i ndotjes se ajrit ne qendrat urbane dhe industriale, erozioni masiv i tokes, demtimi i vazhdueshem i pyjeve, ndotjet e ujrave tokesore dhe detare, kaosi i ndertimeve ne zonat e mbrojtura, perbejne probleme te medha e te renda per zhvillimin e vendit dhe risqe per nje kompromentim te ketij zhvillimi ne afatgjate. Qeveria garanton se brenda 4 viteve, zhvillimi i vendit do te rimarre dimensionet e zhvillimit te qendrueshem. Krahas efekteve pozitive ne permiresimin e mjedisit, qe do te rrjedhin nga zbatimi i teresise se programeve dhe politikave sektoriale, mjedisit do t'i kushtohen programe specifike si me poshte :

- Do te merren me shpejtesi masa per forcimin e disiplinës se ligjit ne mbrojtje te mjedisit. Parimi “demtuesi paguan koston e plote” do te zbatohet me rreptesi. Per kete qellim do te reformohet rrjeti institucional dhe do te forcohen masat ndeshkimore ndaj cdo ndotesi dhe demtuesi te komponenteve mjedisore.
- Me perparesi do te disiplinohen aktivitetet ekonomike qe shkaktojne ndotjen e ajrit ne zonat urbane, ndotjen ne ujrat bregdetare e liqenore dhe qe kompromentojne potencialet turistike, demtimin e pyjeve dhe erozionin e tokes. Brenda dy viteve te para te qeverisjes do te arrihen tregues te larte te rivendosjes se disiplinës ligjore me efekte te prekshme ne cilesine e mjedisit.
- Ne vecanti, do te pergjysmohet niveli i ndotjes se ajrit ne zonat e medha

urbane te vendit. Do te adoptohen plotesisht standartet mjedisore te shkarkimit ne ajer, duke i perafruar me standartet europiane, sipas nje programi ambicioz. Brenda mandatit 4-vjecar te qeverisjes do te eliminoohen ujrat e ndotura siperfaqesore ne zonen bregdetare.

- Do te trajtohen me perparesi te gjitha "vatrat e nxehta mjedisore", me nivel te larte ndotjeje, te trasheguar nga industrite e amortizuara, nepermjet neutralizimit dhe rehabilitimit te tyre dhe, ne raste e domosdoshme, largimit te familjeve qe jetojne te ekspozuara ndaj rrezikut.
- Luftimit te erozionit masiv, si nje nga shkaktaret e permbytjeve dhe demeve te medha njerezore e materiale ne tokat e uleta fushore, do t'i kushtohet nje rendesi paresore. Per kete qellim do te ndalohen veprimtarite e ndryshme shfrytezuese ne vendet me rrezik te larte te erozionit, si dhe do te mbeshtetet fuqishem me programe te posacme rehabilitimi i siperfaqeve pyjore dhe kullosore.
- Krahas forcimit te disiplines, do te adoptohen incentiva per nje sjellje miqesore me mjedisin te aktiviteteve ekonomike e njerezore dhe qe njekohesisht respektojne principet e tregut te lire. Per kete qellim do te adoptohen lehtesira fiskale per uljen e ndotjeve nga bizneset dhe konsumi, per investime ne teknologji te pastra, per konservimin e energjise, per perdorimin racional te burimeve natyrore dhe per nxitjen e investimeve mjedisore. Do te krijohet gjithashtu Fondi per Mjedisin, i cili do te ushqehet nga taksat, gjobat dhe donacionet e brendshme apo te huaja. Investimet e tij do t'i drejtohen teresisht sektoreve te paster mjedisore, apo me ndikim te drejtperdrejte ne mjedis.
- Qartesimi i te drejtave te pronesise dhe garantimi i tyre, transferimi i pronesise se disa burimeve mjedisore ne komunitetet vendore si ne pyje e kullota, shfrytezim i ujerave, tokes etj., do te jete nje tjetër incentiv per nje sjellje miqesore me mjedisin.
- Shfrytezimi pa kriter i faunes se eger do te vihet ne shenjstren e aktiviteteve parandaluese dhe ndaluese. Per kete qellim, do te forcohet sistemi i kontrollit dhe parandalimit te demtimit, si dhe do te rriten masat ndeshkimore per demtuesit.
- Qeveria do te dyfishoje siperfaqen e zonave te mbrojtura, do te garatoje jo vetem mbrojtjen e tyre, por edhe nje zhvillim te metejshem, duke gjetur menyra te aktivizimit te potencialeve te ketyre zonave ne treg pa kompromentuar ruajtjen e tyre.
- Qeveria do t'i kushtoje vemendjen e duhur edhe shfrytezimit racional te burimeve minerare duke hapur tregun dhe duke ofruar lehtesira koncensionare per investitoret vendas dhe te huaj, te cilet garantojne njekohesisht edhe mbrojtjen dhe rimekembjen e mjedisit.
- Informimi i publikut mbi gjendjen reale te mjedisit do te marre nje rendesi vendimtare ne programin mjedisor te qeverise. Shoqeria civile dhe organizatat e pavarura e te specializuara do te ftohen te kontribuojne ne hartimin e politikave mjedisore, ne zbatimin e tyre, si dhe vecanerisht ne monitorimin e gjendjes se

mjedisit. Edukimi i publikut do te mbeshtetet nga programe specifike qe do te realizohen ne bashkepunim me shoqerine civile. Do te rishikohen te drejtat ligjore te publikut dhe do te permiresohen procedurat e ankimit administrativ dhe gjyqesor per t'i dhene akses me te larte grupeve pro-mjedisore te kerkojne mbrojtjen e mjedisit dhe ndeshkimin e ndotesve ne rruge administrative e gjyqesore.

NATYRA SOCIALE E SHTETIT.

36. Maxhoranca e re konsideron se natyra sociale e shtetit eshte jo vetem nje detyrim, por edhe nje qasje efikase ne sherbim te zhvillimit ekonomik e social te vendit. Nje trajtim i tille kerkon qe politikat sociale te shnderrojne thelbesisht natyren e tyre nga pasive ne politika aktive dhe njekohesisht te jene nje investim per rritjen dhe fuqizimin e kapitalit social. Gjithashtu, mazhoranca e re angazhohet te ndermarre politika efektive per nje trajtim efektiv dhe per arritjen e rezultateve te prekshme ne ceshtjen e barazise gjinore.

PUNESIMI I PLOTE. REDUKTIMI I PAPUNESISE

xxiii) Ne Projektin e saj per ndryshim, mazhoranca e re dhe qeveria e saj synojne te krijojne mundesi per punesim te cdo shqiptari. Papunesia, vecanerisht afatgjate dhe e pashprese, si urbane dhe rurale, e vecanerisht me nivelet alarmante te saj mes brezit te ri, trasheguar nga qeverisjet socialiste, perben nje kercenim serioz social dhe nje barriere per zhvillimin e vendit. Papunesia dhe mungesa e shpreses per pune eshte nje nga faktoret kryesore te eksodit masiv emigrator te shqiptareve.

§ I gjithe programi i qeverise, qe synon rritjen e ritmeve te rritjes ekonomike njekohesisht synon edhe qe kjo rritje te krijojte vende te reja pune te mjaftueshme per te ulur papunesine ne nivelin e vendeve europiane, per te perballuar me mundesira punesimi shtesen demografike te popullsise dhe per me teper edhe per te filluar qe te ndikojne ne kthimin e nje pjese te emigranteve.

§ Krahas efekteve pozitive ne punesim si rezultat i politikave te rritjes ekonomike e te zhvillimit njerezor, qeveria do te perdore me efikasitet programe dhe instrumenta te provuara si te suksesshme per te mundesuar axhustimet e difekteve te tregut te punes si psh. instrumentet e informacionit, te ndermjetesimit, te trainimeve profesionale, te incentivave fiskale etj. Programet e nxitjes se punesimit do te zbatohen ne bashkepunim me organizatat e shoqerise civile dhe sektorin privat. Ato do t'i pershtaten realiteteve, nevojave dhe tendencave urbane, rurale e rajonale.

PAGAT DHE PENSIONET

xxiv) Rritja e pageve dhe pensioneve do te jete nje prioritet i politikave buxhetore te mazhorances se re dhe qeverise se saj. Pensionet do te dyfishohen brenda periudhes 4 vjecare

ndersa do te vazhdoje ngushtimi i diferencës së pensioneve të qytetit me ato të fshatit. Në këtë mënyrë, pensionet do të tejkalojnë ndjeshëm minimumin jetik, nivelin e cilin ato mbeten në vitet e qeverisjes socialiste.

§ Qeveria vlerëson se nepermjet luftës kundër evazionit fiskal, gërshtuar me uljen e nivelit të detyrimeve për sigurime shoqërore, si dhe me rritjen e punësimit të uljen e papunësisë do të arrihet në rritjen e të ardhurave për të financuar skemën e pensioneve.

§ Qeveria do të përkrahë edhe iniciativat private të tregut financiar për të gjallëruar skemat e pensioneve vecanerisht nepermjet hapjes së bursës dhe tregut financiar për investime. Detyrimi për kontributin e sigurimeve shoqërore të ulët në nivelin e rreth 35%.

§ Pagat në administratën publike do të rriten, me përparësi pagat e ulta, duke synuar që në fund të periudhës 4-vjeçare raporti mes pages me të lartë dhe me të ulët në administratën publike të jetë 1 me 5. Në këtë sektor do të ngushtohen edhe diferencat e theksuara dhe cbalancimet e krijuara mes degeve të ndryshme duke i dhënë përparësi rritjes së pagave në sektorët e shërbimit të drejtëpërdrejtë të qytetarëve e vecanerisht në arsim, shëndetësi, rend publik. Rritje të ndjeshme periodike do të ketë edhe për pagën minimale të sektorin privat.

REDUKTIMI I VARFERISE DHE KUJDESI SOCIAL

xxv) Zhvillimi i vendit do të jetë një proces i hapur për çdo shqiptar. Në rrugën e zhvillimit askush nuk do të braktiset dhe nuk do të lejohet të mbese prapa. Për këtë qëllim krahas mundësive që do të krijojnë vetë tregu i lirë dhe i hapur për iniciativë private, punësim dhe vetëpunësim, qeveria do të zbatojë politika efektive sociale që jo vetëm mbështesin shtresat dhe individët në nevojë por që në radhë të parë synojnë në mënyrë aktive integrimin e tyre në proceset e zhvillimit.

Reduktimi i varferisë

§ Vitet e ardhshme të qeverisjes së mazhorancës së re do të jetë vitet e luftës frontale kundër varferisë. Reduktimi i varferisë në radhë të parë do të sigurohet nepermjet rritjes me ritme të larta ekonomike njëherazi një rritje përfshirëse për çdo individ dhe të çdo rajoni të vendit.

- Krahas këtyre efektëve, politikave dhe instrumentat sociale do të reformohen në mënyrë të tillë që çdo i varfër të ndihmohet të dalë nga varferia. Fondet për ndihmën ekonomike për familjet e varfëra, në bashkëpunim me qeverisjen vendore do të aktivizohen në formën e përfshirjes në punësim publik. Skemat e nxitjes së punësimit dhe sistemi i trainimeve profesionale do të orientohen vecanerisht ndaj familjeve të varfëra.
- Për të thyer rrethin vicioz të varferisë, qeveria do t'i kushtojë rëndësi prioritare

perfshirjes se femijeve te familjeve te varfera ne arsim me prioritet ate profesional.

- Breda 4 viteve te ardhshme do te pergjysmohet niveli i varferise monetare ndersa asnje shqiptar nuk do te jetoje me nen nivelin ekstrem te varferise ushqimore.
- Permireshimi i sherbimeve publike dhe i aksesit ne to me perparesi per zonat me te varfera te vendit do te coje gjithashtu ne uljen e varferise jo-monetare.
- Tregu i hapur nga nje ane dhe politikat rishperndarese nga ana tjeter do te synojne gjithashtu zbutjen e pabarazise se krijuar gjate viteve te qeverisjes socialiste edhe per shtresa te tjera te popullsise.
- Politikat e reduktimit te varferise do te mbeshteten nga kryerja e studimeve periodike mbi varferine, tiparet e saj, shperndarjen, percaktimin e grupeve me te riskuara etj.
- Qeveria do te jete e hapur per bashkepunim me shoqerine civile si per vleresimin e arritjeve ne politikat e reduktimit te varferise si edhe ne levrimin e sherbimeve ne favor te te varferve.

Kujdesi social per grupet dhe individet ne nevoje

§ Politikat sociale do te behen me efektive dhe do te fitojne nje natyre komunitare dhe perfshirese edhe per grupe specifike ne nevoje si personat me aftesi te kufizuar, jetimet dhe femijet e rruges, nenat kryefamiljare e me shume femije, minorenat, vajzat dhe grate viktime te dhunes e trafikut, perdoruesit dependente te droges, invalidet e punes e te luftes.

§ Qeveria do te investoje ne ngritjen e qendrave moderne te sherbimeve sociale, do te adoptoje forma komunitare te perkrahjes dhe ndihmes ndaj tyre, si dhe do te nxise dhe perkrahe iniciativa te biznesit e shoqerise civile ne kete fushe krahas rritjes se mbeshtetjes financiare direkte per keto kategori shoqerore.

§ Ne vecanti:

- Asnje femije nuk do te braktiset, cdo femije do te kete kujdesin qe meriton
- Kujdes te vecante per femijet me aftesi te kufizuar dhe/ose prinder me aftesi te kufizuar qe rrisin femije, me perparesi ndihme dhe lehtesira per shkollim dhe punesim te pershtatshem.
- Ndhime per femijet e familjeve qe u mungon prindi dhe prinderve me shume femije si kurse kualifikimi, ndihma, bursa per arsimim etj.

Zgjidhja e problemit te familjeve te pastreha

§ Qeveria do të lehtësojë në një masë të madhe ceshtjen e strehimit të familjeve të pastreha. Për këtë qëllim qeveria do të investojë në ngritjen e 4000 apartamenteve të cilat do t'u shpërndahen familjeve të pastreha sipas një sistemi transparent dhe të ndërshtet. Ky objektivi do të arrihet edhe me një bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen vendore dhe sektorin privat. Nderkaq do të zgjidhet brenda këtij mandati ceshtja e familjeve që jetojnë në banesat e ish-pronareve të cilat me mbështetjen që do t'i japë shteti do të pajisen me apartamente në kushte të barabarta me mënyrën se si u pajisen familjet e tjera shqiptare në vitin 1993.

Kujdesi dhe integrimi i ish të përndjekurve politikë

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj do të përkrahë integrimin e plotë të ish të përndjekurve politikë dhe të familjareve të tyre në jetën ekonomike e sociale të vendit duke eliminuar diskriminimin që iu bë atyre rishtaz gjatë viteve të qeverisjes socialiste. Përveç kompensimit të drejtë, në përputhje me ligjet e vendit, të viteve të burgut, rendesi do të marrin edhe forma të tjera të përkrahjes si në arsimin, punësimin, strehimin etj.

Respekti dhe kujdesi pa diskriminim ndaj veteraneve

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj shpreh qartë dhe me sigë respektin për veteranet dhe do t'i japë fund keqpërdorimit politik dhe manipulimit që qeverisja socialiste ka bërë me këtë grup të nderuar heronjsh të vendit. Veteranet dhe organizatat e tyre do të gëzojnë status të vecantë dhe mbështetje të gjithëpërfshirë fiskale e financiare po aq sa edhe morale.

KUJDESI PËR EMIGRACIONIN. INTEGRIMI I EMIGRANTEVE TË RINJË E TË VJETËRË NË ZHVILLIMIN E VENDIT

xxvi) Zhvillimi i vendit i takon të gjithë shqiptarëve kudo që janë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Shqiptarët kanë treguar se posedojnë një kapital social të jashtëzakonshëm i cili ka shfaqur potencialin e vet zhvillues dhe njëzëz në këto vite të vështira të tranzicionit. Emigrantët e këtij brezi janë forca njëzëzore determinante e mbijetesës dhe e zhvillimeve të këtyre viteve. Ata me punën dhe përpjekjet e tyre i kanë treguar kombeve të tjera aftësitë dhe cilësitë e kombit të tyre. Për këtë brez, por edhe për brezin e vjetër të emigrantëve, të cilët kanë kontributë të jashtëzakonshme historike për vendin, qeveria përkushtohet për një integrim të tyre në jetën politike, ekonomike e sociale të vendit si dhe me po aq përkushtim edhe për të drejtat e tyre themelore në vendet ku jetojnë.

Perfshirja aktive e emigranteve ne zhvillimin e vendit

§ Qeveria do te adoptoje programe qe emigrantet te rikthehen dhe te investojne ne vendin tyre duke gezuar perjashtim per tre vite nga tatimi mbi fitimin a tatimi mbi te ardhurat personale. Rrjeti diplomatik dhe konsullor do te ristrukturohet dhe do te permiresoje ndjeshem sherbimet ndaj emigranteve duke qene, nepermjet teknologjise se informacionit, 24 ore i hapur. Qeveria do te investoje per ngritjen e qendrave kulturore dhe per kryerjen e aktiviteteve te ndryshme ne bashkepunim me shoqatat e emigranteve shqiptare kudo qe jane. Ne radhe te pare vemendja do te perqendrohet ne mundesimin e mesimit te gjuhes shqipe nga femijet e emigranteve nepermjet teksteve shkollore dhe mesuesve krahas hapjes se shkollave verore ne Shqiperi.

Perkushtimi per mbrojtjen dhe garantimin e te drejtave te emigranteve

§ Qeveria do te perkushtohet per respektimin e te drejtave te emigranteve ne vendet ku ato jetojne, duke kerkuar nje respektim te standarteve vendore, pa diskriminim dhe ne perputhje me standartet europiane dhe/ose nderkombetare. Ne radhe te pare, perfundimi i procesit te legalizimit te tyre do te mbeshtetet me vendosmeri nga shteti shqiptar.

BARAZIA GJINORE

xxvii) Zhvillimi ekonomik e social i vendit nuk mund te kuptohet pa nje trajtim dhe pa arritje konkrete ne ceshtjet e barazise gjinore. Qeveria do te angazhohet plotesisht ne radhe te pare per t'i prere rrugen njehere e mire dhunes ndaj grave dhe vajzave e shfrytezimit te tyre per qellime prostitucioni apo qellimesh te tjere shfrytezuese. Gjithashtu do t'i kushtohet rendesi politikave dhe masave per parandalimin e dhunes dhe krimit ne familje ndaj grave. Krahas ketyre ceshtjeve, politikat gjinore te qeverise do te synojne nje akses me te larte te gruas ne tregun e punes, ne shanset per karriere zyrtare, politike, biznesi. Me perparesi politikat nxitese e promovuese te barazise gjinore do te perqendrohen ne zonat rurale e te prapambetura te vendit. Politikat e programet e qeverise do te hartohen e zbatohen ne bashkepunim te ngushte me shoqerine civile e ne radhe te pare me organizatat e specializuara ne ceshtjet e barazise gjinore.

INTEGRIMI EUROPIAN DHE EUROATLANTIK.

37. Mazhoranca e re dhe qeveria e saj jane te ndergjegjshme se rruga e anetaresimit ne Bashkimin Europian dhe ne NATO si dy prioritetet madhore te te gjitha shqiptareve kerkojne perpjekje maksimale dhe kontribut te cdo faktori dhe aktori per arritjen e standarteve te kerkuara te funksionimit te shtetit demokratik e ligjor, te ekonomise se tregut e te respektimit te te drejtave themelore te njeriut. Zhvillimi dhe integrimi jane dy ane te se njetes medalje, dy drejtime plotesisht te lidhura e kushtezues te njeri tjetrit. Zhvillimi kalon nepermjet integritit dhe integrimi nepermjet zhvillimit te vendit.

38. Procesi i shpejte integrues kalon permes zgjedhjeve te lira, luftes kunder korrupsionit, krimin te organizuar, trafiqeve e terrorizimit, sigurise se kufijve dhe shtetit ligjor, tregut te lire dhe demokracise funksionale, respektimit te te drejtave te njeriut e te minoriteteve, fqinjesise se mire e bashkepunimit per paqen dhe prosperitetin pa dallim te qytetareve te Ballkanit, te Europes dhe te mbare njerezimit.

39. Zhvillimet e ngadalta e kontradiktore keto vitet e fundit ne keto fusha, instalimi i sistemit te korrupsionit, toleranca ndaj krimin dhe lidhja e tij me politiken, kapja e shtetit, mungesa e zgjedhjeve te lira e te ndershme kane qene nje pengese serioze dhe arsyeja e ngadalesimit deri ne "ngririje" te procesit integrues.

40. I gjithë programi i Mazhorances se re dhe Qeverise se saj eshte ndertuar dhe do te zbatohet me vendosmeri e perkushtim per te mundesuar arrijten e standateve te kerkuara per te merituar te drejten e anetaresimit ne Bashkimin European dhe ne NATO sa me shpejt qe te jete e mundur.

ZBATIMI DHE KOORDINIMI I REFORMAVE EUROPIANIZUESE E INTEGRUESE

xxviii) Mazhoranca e re dhe qeveria e saj vleresojne mbeshtetjen e madhe dhe gadishmerine e plote te Bashkimit European dhe te qeverive te vendeve anetare per zgjerimin e tij edhe ne Ballkanin Perendimor dhe ofrimin e shanseve te plota Shqiperise dhe shqiptareve per t'u bere sa me shpejt pjese e ketij bashkimi.

§ Mazhoranca e re dhe qeveria e saj vleresojne se shanset e integritit european te vendit jane ne duart e vete shqiptareve, suktesi i integritit varet nga ne dhe eshte pergjegjesi e jona. Nderkaq, integrimi european gezon mbeshtetje te plote dhe te palekundur nga cdo faktor dhe aktor i shoqerise shqiptare dhe perben keshtu burimin kryesor te energjise dhe legjitimitetit te kesaj perpjekjeje masive kombetare. Per kete shkak pergjegjesia e klases politike behet edhe me e larte dhe me e plote e ne radhe te pare e mazhorances dhe qeverise se saj qe do mbartin ne kete proces pergjegjesine kryesore.

§ Per arrijten e ketij synimi programi i qeverise eshte ndertuar dhe do te zbatohet ne perputhje me kerkesat e procesit integrues duke i dhene perparesi atyre drejtimeve qe jane evidentuar qartesisht si prioritare dhe me problematike nga vleresimet periodike te bera me objektivet nga Komisioni European. Ne vecanti ceshtjet e lidhura me arrijten e standarteve europiane te demokracise se bazuar ne zgjedhje te lira e te ndershme, te shtetit ligjor e te se drejtes, te garancise se kufijve, te te drejtave te njeriut e te minoriteteve, dhe nje ekonomi tregu te lire do te perbejne objektivin themelor te te gjithë reformave dhe programeve qeveritare.

§ Nga ana tjeter lufta e efektshme kunder korrupsionit, krimin te organizuar e trafiqeve do te ndryshojne imazhin e Shqiperise e te shtetit shqiptar perballe partnereve europiane dhe opinionit publik european duke e bere edhe me te lehte procesin integrues.

§ Qeveria do te angazhohet plotesisht ne procesin e permbylljes se fazes

negociuese te Marrevshjes se Stabilizim Asociimit dhe do te demonstroje qartesisht nje vullnet te ri per te permbushur plotesisht dhe para afateve detyrimet e marra perballe Komisionit European qe mundeson nenshkrimin e kesaj marrevshjeje gjate vitit qe vjen.

§ Pas nenshkrimit te kesaj marrveshjeje, duke plotesuar te gjitha standartet e dokumentacionit te qytetareve dhe kontrollit efikas te kufijve, Qeveria do te kerkoje dhe do beje perpjekje per garantimin e levizjes se lire te qytetareve shqiptare ne territorin e Bashkimit European.

§ Cdo ministri dhe institucion tjetër ne varesi te qeverise do te ndertoje punen, do te raportoje me tregues te matshem dhe do te jete teresisht pergjegjes per cdo progres apo vonese ne kryerjen e reformave europeanizuese e integruese. Qeveria do te marre te gjitha masat organizative per nje koordinim dhe monitorim efektiv dhe eficient te te gjithë aktivitetit te ministrive dhe institucioneve te tjera. Ne cdo institucion do te funksionojne ne menyre eficiente njesite e specializuara per koordinimin dhe monitorimin e reformave europeanizuese.

§ Nenshkrimi i marrevshjes se Stabilizim Asociimit do te vijojë me nje pune intensive e te koordinuar per te realizuar te gjitha kushtet e marrevshjes sipas objektivave dhe afatave te percaktuara.

§ I gjithë procesi i integritit european do te jete i hapur dhe qeveria mirepret kontributet e opozites, te institucioneve Kushtetuese dhe te cdo institucioni tjetër te shtetit te pavaruar nga ajo, shoqerise civile, komunitetit te biznesit, medias dhe cdo shqiptari. Qeveria do te jete e vemendshme dhe perthithese per cdo sugjerim dhe verejtje ne adrese te saj ne kete proces.

§ Qeveria do te jete e vemendshme dhe do te mireprese vleresimet periodike dhe rekomandimet qe Komisioni European, Parlamenti European dhe institucione te tjera europiane do te ndermarrin mbi Shqiperine, duke reflektuar me seriozitet mbi verejtjet dhe sugjerimet dhe duke punuar per zbatimin e tyre.

§ Ne procesin integrues, qeveria do te shfrytetoje edhe eksperiencen e akumuluar ne vende te tjera te sapoanetaresuara apo ne proces anetaresimi ne Bashkimin European. Njekohesisht Qeveria do te bashkepunoje me vendet e tjera te Ballkanit Perendimor per te rritur shanset per me shume akses ne fondet e para anetaresimit te BE-se.

§ Burimet njerezore, financiare dhe cdo faktor tjetër do te orientohen ne sherbim te procesit zhvillues e integrues. Qeveria do te fuqizoje kapacitetet thithese dhe perdoruese te fondeve te dhena nga vete BE-se si dhe nga donatore te tjere duke i orientuar ato teresisht drejt reformave integruese dhe europeanizuese.

§ Procesi integrues european do te mbeshtetet edhe nga programe qe do te synojne informimin dhe edukimin european te te gjithë shtresave te shoqerise me fokus te vecante brezin e ri, promovimin e perthithjen e vlerave europiane ne shoqerine shqiptare duke promovuar njekohesisht vlerat shqiptare dhe njohjen e tyre nga

shoqerite europiane.

POLITIKA E JASHTEME NE FUNKSION TE INTEGRIMIT EUROPIAN E EUROATLANTIK, TE PAQES E STABILITETIT RAJONAL

xxix) Ne drejtim te politikës se jashtme ne konfirmojme vendosmerine tone per t'i qendruar angazhimit qe kemi marre perpara shqiptareve qysh ne themelimin e Partise Demokratike me se 15 vjet te shkuara, per t'i dhene Shqiperise nje vend te respektuar ne familjen e vendeve demokratike. Per kete qellim, gjithë politika e jashtme e qeverise shqiptare ne kater vjetet e ardhshme do te jete ne sherbim te procesit te integritimit te Shqiperise ne Bashkimin European e ne NATO. Krejt veprimtaria diplomatike do te mbeshtese e do te shoqeroje punen e qeverise per kryerjen e reformave te gjithaneshme e te thella qe nevojiten per plotesimin e standarteve pa te cilat nuk ka integrim.

§ Ne konstatojme me kenaqesi se kursi i ndjekur ne politiken e jashtme edhe nga qeverite e majta paraardhese ka qene nje vazhdimesi i qeverise se meparshme demokratike. Qeveria jone mbetet e vendosur ne konsolidimin e konsensusit te gjere me politiken e jashtme, rritjen e profesionalizmit dhe veprimtarise diplomatike. Ne te ardhmen do te zhvillojme me perparesi diplomacine ekonomike. Te bindur se vendi ka nevojte te madhe per investime te huaja, te bindur se vendi ka nje potencial te madh ekonomik te pashfrytezuar, te bindur gjithashtu se Shqiperia ka kapacitete te plota per thithjen e ketyre investimeve dhe duke ecur me vendosmeri me parimin se ne kontekstin e sotem afrimi mes vendeve e popujve kalon ne nje mase te madhe nepermjet shkembimeve te qendrushme ekonomike, trupi diplomatik shqiptar do te jete fuqimisht ne sherbim te promovimit jashte te asaj klime atraktive per biznesin e huaj, qe do te krijoje me perparesi ne vend qeveria. Shqiperise i duhet nje politike e jashtme realiste dhe pragmatiste, ne funksion te nevojave te zhvillimit te saj progresiv.

§ Vendi yne eshte tashme anetar me te drejta te plota ne shume organizata nderkombetare e koalicione, ku me kryesoret jane OKB, Keshilli i Europes, OSBE, Koalicioni Antiterror, Organizata e Frankofonise si dhe dhjetera e dhjetera konventa e struktura nderqeveritare e joqeveritare, me karakter ekonomik, kulturor, ekologjik, shkencor, juridik, arsimor etj. Ne synojme te rritet roli Shqiperise ne keto organizata e konventa, me qellim permiresimin e imazhit te vendit si dhe perfitimi ne terma konkrete nga dhjetra e dhjetra projekte shumepaleshe nepermjet te cilave vendet anetare punojne se bashku per te siguruar nje zhvillim harmonik te rajoneve te ndryshme te planetit.

§ Shqiperia i ka te gjitha potencialet per te zhvilluar nje diplomaci kulturore aktive, qe do t'i sherbeje afirmimit te identitetit tone kombetar te popujt e tjere si dhe shpalosjes se vertete te atyre vlerave per te cilat ka nevojte sot me shume se kurre imazhi i vendit tone. Diplomacia kulturore, siç eshte provuar tashme, mbetet nje rruge me dobi te vecante per terheqjen e turisteve dhe po ashtu eshte nje rruge qe duhet ndjekur me vendosmeri me qellim perfshirjen sa me gjeresisht dhe denjesisht te vendit tone ne procesin global te qarkullimit te vlerave kulturore ne boten e sotme.

§ Shqiperia ka sot marredhenie te mira e shume te mira dypaleshe me te gjitha vendet e botes demokratike. Kjo eshte nje baze e sigurte per te ecur perpara ne zgjerimin dhe intensifikimin e marredheneve me secilin nga keto vende.

§ Marredheniet me Shtetet e Bashkuara te Amerikes mbeten te rendesise paresore strategjike per ne. SHBA eshte aleati i pazevendesueshem i demokracise se re shqiptare. Shqiperia do te vazhdoje te jape kontributin e vet me te gjitha mundesite ne rast nevojje edhe ne rritje ne Koalicionin Antiterror. Por ne fushen e marredheneve dypaleshe jane krijuar te gjitha kushtet tashme per nje prani shume me te dukshme te kapitaleve amerikane ne zhvillimin ekonomik te Shqiperise. Mbeshtetja substanciale qe qeveria amerikane i ka dhene gjate gjithë ketyre viteve Shqiperise nepermjet agjensive te saj per ndertimin e institucioneve dhe krijimin e parametrave te tregut te lire ka nevojje te shoqerohet tashme me investime te drejtperdrejta amerikane veçanerisht ne sektoret strategjike e ata prioritare te ekonomise tone. Realizimi i ketij synimi do te zere nje vend te dores se pare ne marredheniet tona me SHBA.

§ Shqiperia do te vazhdoje te luaje rolin qe i takon per forcimin e paqes e te stabilitetit ne rajon, duke zgjeruar e intensifikuar marredheniet diplomatike, ekonomike, politike e kulturore me te gjitha keto vende. Eshte shume e rendesishme qe Shqiperia nuk ka asnje problem te pazgjidhur me ndonje nga keto vende e po ashtu, ekziston nje kuader i mire marreveshesh me secilin nga keto vende, te nenshkruara e te ratifikuara ne parlament, marreveshje qe kerkojne te shoqerohen me mire me programe realiste shkembimesh ne te gjitha fushat, ne menyre qe te ndjehet dobia e tyre. Kater vitet e ardhshme do te sjellin nje nivel te ri marredhënesh dhe bashkepunimi miqesor Mqedonine, Kosoven, Kroacine, Bosnje-Hercegovinen, Serbine, Malin e Zi dhe vende te tjera te Ballkanit. Ne kemi me te gjitha keto vende nje synim te perbashket e qe eshte integrimi ne BE e ne NATO ndaj edhe gjithë marredheniet mes nesh jane sa ne interes reciprok aq edhe ne sherbim te ketij procesi. Tradita e miqesise me Turqine do te vazhdoje te ushqeje vullnetin tone per rritje te vellimit te shkembimeve ne te gjitha fushat.

§ Afrimit me Bashkimin Europian do t'i sherbeje intensifikimi me perparesi i marredheneve te gjithanshme miqesore bilaterale me secilin nga vendet anetare te ketij Bashkimi dhe ne veçanti me vendet kryesore te tij Gjermanine, Francen, Britanine e Madhe, Italine si dhe me vendet me lidhje tradicionale miqesore si Austria. Aktualisht, vihet re nje zhbllance midis nivelit shume te mire te marredheneve politike e diplomatike dhe nivelit shpesh te ulet te marredheneve ekonomike. Vitet qe vijne presin nje perqendrim te veprimtarise se misioneve tona diplomatike per korrjgimin e ketij disnivele. Greqia dhe Italia, si vende fqinje e mike, me nje arkiv shume te pasur marredhënesh me Shqiperine, njehersh anetare ne BE e ne NATO, do te kene perparesi.

§ Po ashtu, do te synojne zgjerimin dhe pasurimin e marredheneve me nje numer vendesh me peshe te veçante ne zhvillimet e sotme boterore ekonomike e politike si Japonia, Kina, India e Kanadaja, te cilat edhe e kane shoqeruar me ndihma te konsiderueshme procesin e tranzicionit tone gjate gjithë ketyre viteve. Kina mbetet nje partnere e qendrueshme me hapesira ende te pashfrytezuara shkembimesh qofte ne fushen ekonomike, qofte ne ate kulturore.

§ Kater vitet qe vijne do te jene periudhe e nje reforme te gjere ne rretin e perfaqesive tona ne bote, me qellim zgjerimin e pranise tone diplomatike, fuqizimin e misioneve te rendesise se pare si dhe rritjen e perkujdesit te shtetit tone per emigrantet.

SIGURIA KOMBETARE. ANETARESIMI NE NATO. KONTRIBUTI I SHQIPERISE PER PAQEN DHE SIGURINE GLOBALE

xxx) Garantimi i sigurise kombetare eshte nje synim madhor i mazhorances se re dhe qeverise se saj duke e konsideruar kete synim, te tille qe bashkon cdo aktor dhe faktor shqiptar e kombetar. Siguria kombetare eshte nje dhe e pandare nga nje ane me reformat e medha institucionale e ligjore, perfshire reformimin e forcave te armatosura e ato te sigurise, ashtu edhe me procesin e forcimit te aleancave strategjike e te bashkepunimit te Shqiperise me te gjitha vendet ne kuadrin e iniciativave globale per sigurine e njerezimit e ne vecanti te anetaresimit te Shqiperise ne NATO.

§ Shqiperia eshte pjese e nje mjedisi gjeo-strategjik ballkanik me tendenca te qarta pozitive ne fushen e permiresimit te strukturave te sigurise. Procesi e europianizimi te rajonit eshte nje proces shume i rendesishem qe lidhet drejtpersedrejt me te gjitha faktoret e sigurise sone kombetare e rajonale. Ambjenti i ri gjeopolitik ne kuadrin e ketyre proceseve, ndryshimi i natyres se rreziqeve nga ato tradicionale ushtarake ne rreziqe te tjera jo-tradicionale e jo-simetrike do te jene ne fokusin e punes se gjithë strukturave e organizmave qe jane te perfshira ne plotesimin e detyrave ne fushen e rritjes dhe mbrojtjes se sigurise ne Republiken e Shqiperise.

§ Procesi i transformimit te Forcave te Armatosura e reforma ne fushen e sigurise e te mbrojtjes, do te kene ne konsiderate te gjitha ndryshimet qe kane ndodhur e po ndodhin me synim qe t'i pergjigjen sa me drejte te gjitha sfidave ne fushen e ruajtjes se sigurise kombetare rajonale e globale. Ne do t'i permbahemi e do respektojme dokumentet kryesore te miratuara nga Kuvendi i Shqiperise ne fushen e mbrojtjes si: Strategjia e Sigurimit Kombetar e Strategjia Ushtarake e Republikes se Shqiperise duke synuar rishikimin ciklik e permiresimin e tyre ne konsensus me forcat e tjera politike parlamentare.

§ Integrimi ne strukturat e sigurise Euroatlantike eshte nje objektiv strategjik prioritar i politikës se jashtme te Shqiperise. Kjo eshte dhe do te mbetet prioritet i çdo qeverisjeje ne vendin tone. Samitet e fundit te NATO-s ne Prage dhe ne Stamboll kane shtruar qarte para vendeve partnere e aspirante detyra per t'u realizuar. Si nje vend i tille, Shqiperia eshte e angazhuar te ndertoje nje shtet te konsoliduar demokratik, pasi eshte e bindur qe krijimi i nje mjedisi te sigurte dhe te stabilizuar, konsolidimi i institucioneve demokratike dhe fuqizimi i ekonomise jane te lidhura pazgjidhshmerisht me proceset integruese.

§ Anetaresimi i Shqiperise ne NATO do te paraqiste nje shtrirje natyrale te Aleances ne krahun juglindor te saj, pasi pozicioni i favorshem gjeografik do te perputhej me efikasitet ne strategjine e re te NATO-s per rajonin.

§ Si qeveri e nje vendi aspirant dhe partner, ne do te synoje qe nepermjet proceseve transformuese politike, ekonomike, sociale e ushtarake, te bejme te mundur marrjen e fteses per anetaresim ne Aleance ne kohen me te shpejte te mundshme.

§ Qeveria do te intensifikojme punen per realizimin e ketij objektivi strategjik duke krijuar kushtet e duhura strukturave perkatese per realizim te Objektivave te Partneritetit e duke i pasqyruar sa me mire arritjet tona ne dokument e MAP-it, PARP-it e te IPP-se, si dhe punen tone ne kuadrin e iniciativave te Kartes se Adriatikut, te SEDM-it etj.

§ Kontributi i Shqiperise ne ruajtjen e paqes e sigurise eshte nje nga vlerat me te çmuara, nje nga arritjet me pozitive qe na ben te ndjehemi krenare e dinjitoze ne mes komunitetit te kombeve.

§ Shqiperia, ishte i pari vend ish-komunist qe kerkoi qe ne fillimet e pluralizmit partneritetin dhe anetaresimin ne NATO. Shqiperia iu pergjigj kerkeses se SHBA dhe NATO per "Partneritetin per paqe" dhe qe ne vitin 1996 po kontribuon realisht ne ruajtjen e paqes e sigurise rajonale ne Bosnje Hercegovine duke plotesuar ne menyre profesionale misionin e vet.

§ Pas ngjarjeve tragjike te 11 shtatorit 2001, Shqiperia po kontribon me trupa paqeruajtese ne misionin e "ISAF"-it ne Afganistan, dhe pas çlirimit te Irakut nga regjimi i Sadam Hyseinit ne po marrim pjese ne operacionin e ruajtjes se paqes "Liria e Irakut" ne Mosul.

§ Qeveria vlereson dhe mbeshtet pjesemarrjen e shume oficerëve e nenoficerëve te tjere te Forcave tona te Armatosura ne misionet paqeruajtese te Kombeve te Bashkuara ne Gjeorgji, apo prezencen aktuale te personelit ushtarak shqiptar ne shtabe te ndryshme ushtarake nderkombetare.

§ Qeveria eshte e vendosur qe misionet paqeruajtese dhe roli i Shqiperise ne paqen dhe sigurine globale te rritet e te shtohet pasi keshtu i sherbejme sigurise sone dhe garantimit te vlerave te perbashketa te njerezimit. Ne cdo rast vendimet perkatese do te merren ne konsultim me opoziten, institucionet kushtetuese dhe me cdo faktor tjeter te rendesishem kombetar.

100 DITET E PARA TE QEVERISJES DHE VITI 2006

41. Gjendja e rende e problematike e vendit perkundrejt sfidave te medha qe na presin, kerkojne nje qeverisje efektive dhe eficente qe ne ditet e para te saj. Qeveria do te rivendose ritmin e pershpjtuar

te punes ne te gjithë administratën qendrore të ekzekutivitetit si dhe do t'i kerkoje cdo institucioni të pavarur bashkepunim ligjor por të perkushtuar për të mundësuar futjen e vendit sa më shpejt në rrugën e zhvillimit të integritetit

100 DITET E PARA TË QEVERISJES

42. Në njëqind ditë të para deri në fund të vitit 2005, synimet themelore të qeverisë dhe drejtimet kryesore të punës së saj janë:

I. Rikthimi i besimit tek shqiptarët së lufta kundër korrupsionit do të jetë e suksesshme duke ndermarre:

- i. Krijimin e Task-force anti-korrupsion nën drejtimin e kryeministrit. Ngritjen e komitetit anti-korrupsion të mirëqeverisjes. Adoptimin e planit të detajuar të masave anti-korrupsion;
- ii. Aktivizimin e menjehershëm të kontrollit të brendshëm;
- iii. Aktivizimin e linjës konfidenciale të ankimit për rastet e korrupsionit;
- iv. Lidhjen e një marrëveshjeje bashkepunimi me shoqërinë civile;
- v. Ngritjen e qendrave të informimit të publikut. Aplikimi i teknologjisë së informacionit për një komunikim aktiv me publikun në institucionet qendrore të ekzekutivitetit;
- vi. Zbatimin e ligjit për konfliktin e interesave. Amendimi i tij në pikat e dobëta;
- vii. Rishikimin dhe pershtatjen e imunitetit të zyrtarëve sipas rekomandimeve dhe modeleve më të avancuara europiane;
- viii. Rishikimi i ligjit të prokurimeve dhe adoptimi i institucionit të ombudsmanit të prokurimeve;

II. Impenjimi i menjehershëm në luftën kundër krimit të organizuar e trafikëve nepermjet:

- i. Ristrukturimit të institucioneve kryesore me rol në këtë fushë dhe largimi, bazuar në prova, i punonjësve të inkrimuar;
- ii. Goditjes së shpejtë të grupeve të njohura kriminale;
- iii. Vëndosjes së menjehershme të një bashkepunimi kapilar me institucione të specializuara ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve;
- iv. Uljes së ndjeshme të krimit ordiner;
- v. Vëndosjes së disiplinës në qarkullimin rrugor dhe uljen e numrit të aksidentëve;

III. Realizimi i objektivave makroekonomike, fiskale e buxhetore të angazhuara edhe në marrëveshje me FMN e BB nepermjet:

- i. Masave të menjëreshme për rivendosjen e disiplinës fiskale, fillimin e restrukturimit të organeve tatimore e doganore dhe largimin e punonjësve të korruptuar mbi bazën e provave.
- ii. Pergjysmimit të menjehershëm të tatimeve e taksave të

biznesit te vogel.

- iii. Pershpejtimet te programeve te kryerjes se investimeve publike ne sektoret prioritare, ndjekja me perparesi e realizimit te tyre.
- iv. Reduktimit te menjehershme te shpenzimeve administrative qeveritare dhe rialokim i tyre ne prioritetet e zhvillimit.
- v. Rritjes se pagave dhe pensioneve.

IV. Rishikimi i objektivave afatmesme te Strategjise Kombetare te Zhvillimit Ekonomik e Social dhe i Programit Afatmesem Buxhetor duke i perputhur ato me objektivat ambicioze te programit te mazhorances se re.

- i. Cdo ministri do te rishikoj dokumentat baze te strategjive sektoriale duke adoptuar objektiva me ambicioze ose duke hartuar strategji te reja ne perputhje me programin e qeverise per te gjitha fushat dhe sektoret prioritare te ketij programi.
- ii. Procesi do te jete teresisht i hapur per perfshirje ne konsultime te shoqerise civile dhe te komunitetit te biznesit. Kuvendi do te jete gjithashtu plotesisht i perfshire ne kete proces.

V. Pergatitja e paketes fiskale e buxhetore per vitin 2006

- i. Programi buxhetor dhe fiskal 2006 do te jete gati brenda muajit tetor 2005. Projekt-buxheti do te bazohet ne prioritetet qeverisese, strategjite kombetare, procesit te integritit dhe do te behet ne konsultim te hapur si asnjehere me pare me institucionet publike, qeverisjen vendore, shoqerine civile, komunitetin e biznesit, sindikatat dhe grupet e tjera te interesit. Mbledhjet e qeverise per projekt-buxhetin do te jete te hapura per publikun. Procesi i buxhetimit do te bazohet ne Sistemin e Planifikimit te Integruar qe do te filloje te zbatohet nga qeveria qe kete vit.
- ii. Diskutimi i programit buxhetor dhe fiskal 2006 do te filloje me heret se kurre ne Kuvend ne menyre qe t'i jepet mundesi te gjitha aktoreve te interesit te perfshihen edhe ne kete stad te dyte.

VI. Kryerja e riorganizimit te ekzekutivit qendror sipas principit te nje qeverie te vogel por eficente,

- i. Sipas kompozimit te qeverise me pak kabinete, do te behet edhe ristrukturimi i ministrive dhe institucioneve qendrore te ekzekutivit;
- ii. Do te mbyllet ose shkurtohen nje rrjet i tere institucionesh parazitare rreth Keshillit te Ministrave dhe ministrive;

VII. Rivendosja e disiplines financiare ne Korporaten Elektroenergjetike.

- i. Ndryshim i stafit te larte drejtues te korporates.
- ii. Largim i punonjesve te korruptuar bazuar ne prova.
- iii. Kryerje e nje kontrolli te thelle financiar ne kete kompani.
- iv. Fillimi i reduktimit progresiv te faturimit aforfe dhe vazhdimi i pershpejtuar i vendosjes se matesave.
- v. Sigurimi i furnizimit me energjie elektrike per dimrin 2005-2006 dhe zvogelimi i nderprerjeve te energjise.
- vi. Eliminimi i medodave diskriminuese ne shperndarjen rajonale te energjise.
- vii. Rritja e arketimeve dhe ulja e ndjeshme e abuzimeve me

energji elektrike te konsumatoreve te pandergjegjshem.

VIII. Hapja e shpejte e tregut te telekomunikacioneve

i. Rivleresimi i kontrates se shitjes se Albtelecom me ekspertize nderkombetare.

ii. Vendosja e disiplines financiare ne kete shoqeri.

Ndryshimi i stafit te larte drejtues dhe largimi i punonjesve te korruptuar mbi bazen e provave.

iii. Anullimi i te gjitha kontratave korruptive e ne konflikt interesi. Eliminimi i trajtimeve diskriminuese te operatoreve rurale dhe te sherbimeve te informacionit

iv. Pergatitja e plote per hapjen e tregut te telekomunikacioneve ne vitin 2006. Rritje e kerkeses per funksionim efektiv te entit rregullator nepermjet monitorimit parlamentar.

IX. Permiresimi i paketes se nderhyrjes ne procedurat administrative. Fillimi i zbatimit te saj.

X. Sigurimi i nje hapjeje te mbare te vitit akademik 2005-2006.

i. Ministria e Arsimit ne bashkepunim me qeverisjen vendore do te angazhohen me nje prioritet te larte per te finalizuar te gjitha pergatitjet e duhura per vitin shkollor 2005-2006. Do te rishihen mundesite per rritjen e fondeve publike per arsimin nga buxheti i shtetit per periudhen e mbetur te vitit 2005.

ii. Do te pergatitet plani i masave per hapjen e arsimit te larte publik per vitin e ardhshem akademik.

XI. Rishikimi i reformes ne sektorin e shendetesise ne perputhje me programin e qeverise. Garantim i kryerjes se investimeve dhe furnizimit me mjete duke alokuar me shume fonde nga buxheti pas rishikimit te tij per periudhen e mbetur te vitit 2005.

XII. Nisja e pergatitjeve per vitin turistik 2006

i. Si asnje here tjeter, pergatitjet per vitin turistik 2006 do te fillojne qe ne vitin 2005.

ii. Me prioritet do te konsiderohen programimi i nderhyrjeve kryesore ne infrastrukture dhe sherbime baze.

iii. Prishja e ndertimeve abuzive qe kompromentojne zonat turistike dhe largimi i mbeturinave te prishjeve.

iv. Pergatitje e programit te punes per zhvillimin e turizmit.

v. Rishikimi i paketes ligjore per turizimin.

vi. Hartimi dhe fillimi i zbatimit te planit te punes per 24 ore furnizim me uje dhe energji elektrike per zonat turistike ne veren e vitit 2006.

XIII. Marrja e te gjitha masave logjistike dhe institucionale per t'i paraprire shirave te vjeshtes dhe dimrit 2005-2006 duke minimizuar demet e mundshme.

XIV. Rishikimi i ligjit per legalizimin e banesave dhe rifillimi i procesit ne perputhje me ndryshimet ligjore.

XV. Vendosja e disipline ne sektorin e ndertimeve dhe cilesine e karburanteve per te filluar uljen e ndotjes se ajrit ne qytetet kryesore te vendit. Nderprerja e shfrytezimit shkaterrimtar te shtreterve te lumenjve. Nderprerje e prerjeve/shfrytezimit demtues te pyjeve, demtimin e kullotave dhe prerje e demtime te tjera qe krijojne risk te larte erozioni. Nderprerje e gjuetise e peshkimit ilegal e me mjete shkaterrimtare.

XVI. Rishikimi i ligjit per kthimin dhe kompensimin e pronave ne perputhje me programin e mazhorances se re. Llogaritje e sakte dhe transparente e kosos dhe hartimi i programit te kompensimit. Fillimi i zbatimit te procesit te kthimit dhe kompensimit te pronave brenda vitit 2005.

XVII. Llogaritje e sakte dhe transparente e kosos dhe hartimi i programit te kompensimit te ish-te perndjekurve politike ne bashkepunim me shoqatat e ish-te perndjekurve politike. Fillimi i zbatimit qe ne fillim te vitit 2006.

XVIII. Hartimi i nje programi te vecante te mbeshtetjes dhe perkrahjes se komunitetit rom dhe egjiptian ne bashkepunim me shoqatat e tyre dhe me organizmat nderkombetare.

XIX. Hartimi i nje programi emergjent per shkollimin e “femijeve qe punojne ne rruge” dhe mbeshtetjen e familjeve te tyre.

XX. Nisja e procesit pergatitor per zgjedhjet vendore te vitit 2006 sipas nje procesi te hapur e konsultues me te gjitha forcat politike, qeverisjen vendore, partneret nderkombetare. Diskutimin dhe gjetjen e rrugeve me te pershtatshme per perfshirjen e emigranteve ne votime.

XXI. Permbyllja e fazes negociuese te Marreveshjes se Stabilizim Asocijimit, marrja e angazhimeve te qarta te permbushjes se detyrimeve te ndermarra para Komisionit European dhe pergatitja e kushteve per nenshkrimin e marreveshjes.

XXII. Vazhdimi i reformes ne forcat e armatosura dhe kryerja e detyrave qe lidhen me anetaresimin ne NATO

VITI 2006 I QEVERISJES

43. Viti 2006 i qeverisjes do te shenoje sukseset e para te prekshme e te qendrueshme te nje qeverisje “me duar te pastra”, te perkushtuar dhe vizionare. Zbatimi i programit qeverises do te zhvillohet ne te gjitha drejtimet prioritare pa boshlleqe dhe zvarritje. Viti 2006 do te jete viti i qeverisjes me marreveshje te Stabilizim Asocijimit te nenshkruar. Per vitin 2006 qeveria i garanton shqiptaret se do te arrije objektivat e kryesore te meposhtem:

I. Kryerjen e zgjedhjeve vendore 2006 te lira, te drejta e te ndershme dhe kryerje me hapa te shpejte dhe te qendrueshem te reformave kryesore institucionale dhe ligjore.

II. Rezultate konkrete ne luften kunder korrupsionit dhe krimet te organizuar e trafikeve. Shqiperia do te rezultoje ne te gjitha raportet nderkombetare per vitin 2006 vendi qe po demonstroi vullnet dhe rezultate te prekeshme.

III. Rikthimi i rritjes ekonomike ne nivelin e mbi 6 %.

IV. Rritje me rreth 40% te shkalles se kreditimit te ekonomise. Ulja e numrit te diteve te regjistrimit te nje biznesi nga 47 qe eshte sot ne jo me shume se 10 dite. Rritja me me shume se 15% e numrit te bizneseve aktive. Rritje e punesimit me 5% dhe ulje e papunesise me rreth 20% perkundrejt nivelit aktual.

V. Aktivizimi i tregut te kapitaleve. Vendosja ne pune e Burses se Tiranes.

VI. Zbatimi i objektivave te politikës fiskale sipas planit te pershkallezuar.

VII. Rritja e te ardhurave buxhetore ne nivelin e 25% te PBB qe kete vit.

VIII. Rritja e shkalles se investimeve publike ne rreth 3.5% te PBBse sipas prioriteteve te programit.

IX. Rritja e pagave ne nivelin e 10% dhe e pensioneve ne nivelin e 15%. Me prioritet pagat e ulta. Rritje edhe me e larte e mbeshtetjes per grupet dhe individet ne nevoje. Rritje edhe me e larte pages se arsimit dhe e sektorit te shendetesise.

X. Rritja e shkalles se decentralizimit fiskal me te pakten 30% me te larte se ai ne vitin 2005. Kryerja e hapave te tjere konkrete te decentralizimit ne sferen e funksioneve te perbashketa.

XI. Nisja e punimeve per autostraden Lushnje-Fier dhe rifillimi serioz i punimeve ne autostraden Durres-Morine.

XII. Hapja e plote e tregut te telekomunikacioneve.

XIII. Ristrukturimi i plote i KESH. Instalimi i te gjithë matesave elektrike dhe eliminimi i plote i fatures aforfe. Kryerja e investimeve ne rritjen e kapaciteteve prodhuese, transmetuese dhe shperndarese. Hartimi i paketes se planit privatizues te KESH. Hapja reale e tregut te energjise.

XIV. Perfundimi i procesit te legalizimeve te ndertimeve. Pergatitja e programeve te urbanizimit te ketyre zonave ne qytete kryesore te vendit.

XV. Mbyllja e te gjithë problemeve emergjente ne te gjitha godinat shkollore. Ecuri e shpejte ne kryerjen e investimeve kapitale ne kete sektor. Fillimi i investimit te teknologjise se informacionit ne shkolla. Fillimi i zbatimit te reformes arsimore.

XVI. Fillimi i zbatimit te strategjise se rishikuar te sektorit te shendetesise. Permiresim ne sherbimin paresor dhe ambulator. Rritja e ndjeshme e shkalles se mbulimit te ketij sherbimi nga skema e sigurimeve shendetesore.

XVII. Sigurimi i furnizimit me uje e energji 24 ore per te gjithë qytetet turistike nga Saranda deri ne Velipoje.

XVIII. Pergjysmim i nivelit te ndotjes se ajrit ne Tirane dhe disa nga qytetet kryesore te vendit. Bllokim i plote i ndertimeve abuzive ne zonat turistike dhe ne qendrat urbane. Bllokimi i plote i shfrytezimit te shtreterve te lumenjve dhe te demtimit te pyjeve e kullotave. Fillimi i zbatimit te strategjive dhe planit te masave per mbrojtjen dhe administrimin e integruar te mjedisit.

XIX. Fillimi i ndertimeve te banesave per te pastrehet. Ne vitin 2006 do te filloje ndertimi i te pakten 500 apartamenteve te para.

XX. Zbatimi sipas programeve te kompensimit te te perndjekurve politike dhe te kthimit e kompensimit te pronave.

XXI. Progres sipas progamit dhe objektivave te matshem per te gjithë fushat dhe sektoret e tjere.

XXII. Vazhdim i reformave ne forcat e armatosura dhe pergatitje e plote per anetaresim ne NATO ne vitin 2007.

XXIII. Sigurimi i vleresimit maksimal nga ana e Komisionit European per ecurine e zbatimit te marreveshjes se Stabilizim Asocijimit dhe te planit perkates te masave.

XXIV. Vleresim maksimal nga Komisioni European, SHBA dhe insitucionet e tjera nderkombetare per respektimin e te drejtave te njeriut e te minoriteteve si dhe ne arritjet ne luften kunder korrupsionit, krimit te organizuar, trafikeve dhe terrorizimit